

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**


**Për Programin e studimit MSc në E Drejtë Civile dhe Tregtare**

**Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

**Prof. As. Hemion Braho**


**Prof. As. Nada Dollani**



(Qershor, 2019)

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit MSc E drejtë Civile dhe Tregtare**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marëdhënieve Ndërkombëtare
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMAS Nr. 345 datë 17.09.2015
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Vendim i Bordit të Akreditimit, Nr. 39, datë 19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në E drejtë Civile dhe Tregtare
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/4 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Kohë e plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Ofrohet nga institucioni
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë 2017-2018 2018-2019	75 79



## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit MSc në E drejtë civile dhe tregtare

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (përmendur në vijim me inicialet UMSH) është krijuar në vijim të VKM Nr. 177, datë 19/02/2009 “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit të arsimit të lartë SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, fillimisht e njohur si Shkolla e Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë”. Me urdhrin Nr. 278, datë 19/05/2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit është miratuar ndryshimi i statusit të këtij institucioni nga Shkolla e Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë” në Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Institucioni është në pronësi të personit juridik “Qendra Mesdheu” sh.p.k., e cila ka nisur veprimtarinë e saj në bazë të vendimit Nr. 42, datë 06/07/2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

UMSH përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, të cilët organizojnë studime të ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master i Shkencave e Master Profesional. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare zhvillon programet: Bachelor në Juridik, Master i Shkencave në e Drejtë Publike, Master i Shkencave në e Drejtë Civile dhe Tregtare, Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile në Studime Evropiane dhe Studime Mesdhetare.

UMSH është akredituar institucionalisht si dhe janë akredituar programet e tij të studimit të ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Profesional, me urdhrat Nr. 124, datë 29/03/2012 dhe Nr. 291, datë 11/07/2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Programi i studimit Master Shkencor në të Drejtë Civile dhe Tregtare i Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë ka filluar të zbatohet në bazë të VKA që rekomandon hapjen, nr. 63, datë 29.06.2015. Me Vendim të Senatit Akademik të UMSH nr.6/1, datë 2017.05.2019 është vendosur që programi të kalojë nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në Fakultetin e Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (Departamenti i të Drejtës Civile). Akreditimi i parë është vendosur me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 39, datë 19.05.2017 (kohëzgjatja 2 vite, me afat 31.07.2019).

Programi është i rekomanduar për studentë të diplomuar në shkencat juridike ose ekonomike si dhe në shkencat të përafërta, të cilët duan të ndërmarrin një karrierë në fushën përkatëse nëpërmjet thellimit të njohurive në fushën e të drejtës civile dhe tregtare.

Përsa i përket numrit të studentëve, siç është verifikuar edhe nga GVJ:

- Viti i parë 2017-2018 ka pasur 75 (shtatëdhjetë e pesë) studentë të cilët kanë ndjekur studimet dhe janë diplomuar në nivelin MSc në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.
- Viti i dytë 2018-2019 ka 79 (shtatëdhjetë e nëntë) studentë që ndjekin studimet dhe janë diplomuar në nivelin MSc në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.

Gjithsej aktualisht vazhdojnë studimet në këtë program 154 studentë.

Ky program është i organizuar në lëndë mësimore, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof.Asoc.Dr. Hemion Braho dhe Prof.As Nada Dollani si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistet e ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku

Me datë 14.06.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 21.06.2019 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

### Memo

Përsa i përket komenteve lidhur me seksionin 1 të vlerësimit (Misioni/Objektivat e programit të studimit) GVJ vlerëson jo të bazuara shpjegimet e Institucionit, kështu që vendos të *mos i ndryshojë sugjerimet e dhëna*.


Përsa i përket komenteve lidhur me seksionin 3 të vlerësimit (Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit) GVJ vlerëson të bazuara sqarimet lidhur me pikën 6 dhe pikën 8, faqja 17, të raportit dhe për këtë arsye vendos ta eliminojë këtë sugjerim. Lidhur me pikat e tjera të këtij seksioni, GVJ vlerëson jo të bazuara shpjegimet e Institucionit, kështu që vendos të mos i ndryshojë sugjerimet e dhëna.

Përsa i përket komenteve lidhur me seksionin 6 të vlerësimit (Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë) GVJ vlerëson jo të bazuara shpjegimet e Institucionit, kështu që vendos të *mos i ndryshojë sugjerimet e dhëna*.

Lidhur me komentet mbi seksionin 7 të vlerësimit (Programi i studimit, organizimi i tij) GVJ vlerëson se sqarimet mbi pikën 3 faqja 34 mund të jenë të vërteta, pasi kjo është një çështje fakti, sikurse është edhe gjetja në RVJ. Në RVJ thjesht është konstatuar se dokumenti lidhur me studimin e tregut nuk lidhet vetëm programin e studimit në proces akreditimi. Në RVJ është cituar dokumenti relevant në faqen dhe në pikën përkatëse (Analizë e Nevojave të Tregut për hapjen/zhvillimin e programeve bachelor dhe master në SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë", shtator 2015, f. 3, pika 4).

Lidhur me komentet mbi pikën 4, faqja 34, GVJ vlerëson se lidhur me lëndën 'E Drejta Private Europiane' dhe 'Të drejtën tregtare e thelluar' sugjerimet e dhëna në RVJ janë në funksion të përmirësimit, ato nuk janë konstatuar si krejt të papërshtatshme, por thjesht syllabuset e këtyre lëndëve krahasuar me syllabuset e lëndëve të tjera brenda të njëjtit program kishin nevojë për një azhurnim më bashkëkohor. Në të dyja rastet nuk kemi përputhje të plotë midis emërimit të lëndës dhe përmbajtjes.

Lidhur me komentet mbi seksionin 10 të vlerësimit (Kërkimi shkencor) GVJ vlerëson se sqarimet mund të qëndrojnë, dhe nuk ka asnjë mohim të tyre në RVJ, por të dhënat në sqarime nuk lidhen specifikisht me të drejtën civile dhe tregtare. RVJ konstaton fakte lidhur vetëm me fushat e së drejtës që trajton programi konkret, pra fushën e të drejtës civile dhe tregtare.



## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të evidentohet roli i Këshillit të Administrimit në aktet përkatëse;
- b) Të shtohen kontaktet midis studentëve dhe drejtuesve të punimeve kërkimore -shkencore si dhe të përmirësohet evidentimi i hapave që do të ndiqen deri në përfundim të tij;
- c) Të rritet pesha e vlerësimeve përgjatë semestrit krahasuar me atë të vlerësimit në provimin final;
- d) Të realizohet një studim tregu lidhur me nevojat që ka tregu vendas dhe ai rajonal;
- e) Materialet e depozituara nga pedagogët/titullarët e lëndëve të këtij programi studimi në bibliotekën e Institucionit të jenë të miratuara nga Departamenti.

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin *Të evidentohet roli i Këshillit të Administrimit në aktet përkatëse*, institucioni ka modifikuar aktet rregulluese institucionale, posaçërisht Statutin e UMSH (nenet 24-29) dhe Rregulloren Organizative të Institucionit (Neni 15, etj.), ku ka përfshirë në bazë të ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, organizimin dhe funksionimin e Bordit të Administrimit si organi më i lartë drejtues në çështjet e administrimit të Institucionit.

#### **Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar**

- b) Për rekomandimin *Të shtohen kontaktet midis studentëve dhe drejtuesve të punimeve kërkimore - shkencore si dhe të përmirësohet evidentimi i hapave që do të ndiqen deri në përfundim të tij*, institucioni ka përmirësuar mjetet komunikuese dhe aktivitetin shkencor ndërmjet studentit dhe pedagogut, nëpërmjet rregullimit që në fazat e para të ofertës shkencore nga ana e pedagogut dhe seancat metodologjike për përgatitjen e tezës shkencore përfundimtare. Po ashtu ka kontribuar pozitivisht përfshirja e studentëve në fushën përkatëse të ekspertizës së pedagogut dhe në projektet shkencore.

#### **Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar.**

- c) Për rekomandimin *Të rritet pesha e vlerësimeve përgjatë semestrit krahasuar me atë të vlerësimit në provimin final*, institucioni ka reflektuar këtë rekomandim, siç është konstatuar nga GVJ në takimet me studentët dhe pedagogët, duke shpërndarë peshën e vlerësimit në angazhim në seminar (10%), detyra kursi (30%), dhe provim përfundimtar (60%). Këto komponentë janë të evidentuar edhe në syllabusin e lëndës.

#### **Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar.**


- d) Për rekomandimin *Të realizohet një studim tregu lidhur me nevojat që ka tregu vendas dhe ai rajonal*; institucioni ka reflektuar këtë rekomandim duke paraqitur si evidencë një studim mbi nevojat e tregut. Evidenca përfshin studimin e tregut për të gjitha drejtimit e UMSH, dhe jo posaçërisht për programin MSHC. Në pikën 4, f. 3 e dokumentit 'Analizë e nevojave të tregut për hapjen/zhvillimin e programeve bachelor dhe master në SHPL "Mesdhetare e Shqipërisë"

#### **Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar**

- e) Për rekomandimin *Materialet e depozituara nga pedagogët/titullarët e lëndëve të këtij programi studimi në bibliotekën e Institucionit të jenë të miratuara nga Departamenti*, institucioni ka reflektuar këtë

rekomandim duke miratuar formularë të posaçëm për kërkesat e pedagogëve, ku komponent i domosdoshëm është miratimi i Përgjegjësit të Departamentit.

**Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i plotësuar**



## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkruese

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Në verifikimin a akteve rregullues të IAL-së, GVJ ka konstatuar që statuti dhe rregulloret e Institucionit janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet normative në fuqi. Me urdhrin Nr. 278, datë 19.05.2017, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është miratuar ndryshimi i statusit të këtij Institucioni të Arsimit të Lartë nga Shkollë e Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë” në Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, përfaqëson një nga fakultetet kryesore të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”.

Siç shfaqet në dokumentat orientues të përgatitura nga IAL nën vlerësim, programi i studimit synon t’u ofrojë studentëve përvetësimin e kulturës ligjore bazë, si dhe pajisjen me instrumentet themelore të nevojshme për të përditësuar aftësitë e tyre, kërkim të pavarur shkencor në fushën e studimeve të së drejtës civile dhe në mënyrë specifike, të së drejtës tregtare, si dhe organizimi i aktiviteteve plotësuese për zhvillimin e mëtejshëm e aftësive të veçanta dhe kapacitetet interpretuese të studentëve. Etika profesionale, logjika dhe argumentimi juridik janë aspekte plotësuese të këtij programi të evidentuara kundrejt GVJ nëpërmjet materialeve strategjike dhe rregullativë të IAL-së.

Institucioni ka përgatitur një Plan Strategjik i cili është i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimit si edhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.

Rezultoni se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka bërë një studim analitik të tregut të punës. Nga ky studim rezultoni se Masteri i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare është një program i kërkuar pikërisht nga juristë të cilët duan të thellohen në fushën e të drejtës civile dhe tregtare, me qëllimin kryesor të punësimit pranë organeve publike dhe jo-publike, ose pranë institucioneve dhe administratës gjyqësore, në fushën e ndërmjetësimit dhe përmbartimit, zyrave të avokatisë dhe noterisë, personave juridik dhe shoqërive tregtare private, sistemit bankar etj.

Ky program studimi dhe përgatitja e dokumentave strategjike janë përpiluar edhe në konsideratë të zhvillimit socialo-ekonomik të vendit tonë.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit në E Drejtë Civile dhe Tregtare, është rishikuar që nga akreditimi i fundit bazuar në qëllimet, misionin dhe objektivat e institucionit, të cilat janë të shprehur në planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” dhe të planit strategjik të zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ekzistenca e Planit Strategjik të UMSH-së, ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm, të
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë	

<p>vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>planifikuar e të mirë menduar të zhvillimit të programit të studimit si edhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.</p> <p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka bërë një studim nëpërmjet analizës të tregut dhe ka arritur në përfundimin se Masteri i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare është një program i kërkuar veçanërisht nga juristë të cilët duan të përfitojnë studime të thelluara në fushën e të drejtës civile dhe tregtare, me qëllim punësimin pranë institucioneve publike dhe jo-publike, ose pranë organeve të administratës gjyqësore, në fushën e ndërmjetësimit dhe përmbarimit, zyrave të avokatisë dhe noterisë, personave juridik dhe shoqërive tregtare private, sistemit bankar etj.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin social-ekonomik në vendin tonë. Programi i studimit paraqet elementët e konkurrueshmërisë në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara.</p> <p>Programi i studimit që nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare është përshtatur në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH-së por gjithashtu edhe me Planin Strategjik të Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Kjo reflektohet në punën e vazhdueshme për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik, vazhdimësinë dhe rritjen e bashkëpunimeve, nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.</p> <p>Programi ka përcaktuar objektiva që përputhen me strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “E Drejtë Civile dhe Tregtare” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat lidhen me fushën e studimit, emërtimin e programit, nivelin dhe kapacitetet akademike të njësisë ku zhvillohet</p>



përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

ky program studimi (MSc). Ky program studimi MSc. është në përputhje dhe me emërtimin e titullit të diplomës përkatëse (të realizuar për dy vite akademike me 120 ECTS gjithsej). UMSH ka përgatitur programin e nivelit të dytë të studimit 5 vjeçar referuar GVJ në stadin aktual të një drafti. Programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare, i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit

**Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Programi i studimit MSc. synohet të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me planin e zhvillimit strategjik dhe politikën e zhvillimit të programeve të studimeve master. Konkretisht, synohet:

Rritja e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimi i kurrikulave, mbështetja për rritjen e zhvillimit shkencor, përfshirja e studentëve në aktivitete të ndryshme.

- Universiteti ka hartuar planin strategjik në nivel institucional i cili reflektohet në programin “Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare” në përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënit i cili përfshin:

- Vlerësimin e performancës bazuar në parametra të matshëm;
- Inkurajimi i pedagogëve për pjesëmarrjen në aktivitete kërkimore shkencore dhe nxitjen e debatit mediatic në fushat përkatëse;
- Komunikimin në auditor dhe interaktivitetin real;
- Përfshirjen e studentëve në punë të pavarur shkencore;
- Nxitjen e diskutimeve teorike-aplikative
- Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse infrastrukturore e teknologjike si: pasurimi i bibliotekës me titujt më të fundit, apo portal i pedagogut;
- Pjesëmarrjen në aktivitete shkencore të organizuara nga institucioni

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, bazuar në dokumentacionin që zotëron, disponon një plan të zhvillimit strategjik, ku ka përcaktuar dhe artikuluar qartë vizionin dhe misionin e tij.
2. Programi i studimit MSc. “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, është i përshtatshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e

lëndëve, kreditet (ECTS), metodat e vlerësimit dhe kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara.

3. Programi MSc. në “E Drejtë Civile dhe Tregtare”, promovon studimin dhe kërkimin shkencor, jo vetëm në çështje klasike të së drejtës civile, por edhe në fushën e të drejtës private europiane, e drejtë tregtare ndërkombëtare, e drejtë tregtare e BE-së etj., duke i trajtuar ato në një këndvështrim krahasues e të thelluar, në përputhje me risitë në vendin tonë dhe zhvillimet aktuale globale.
4. Nevojat e tregut dhe kompleksiteti i çështjeve të trajtuara do të kërkonin organizimin e programit në funksion të një specializimi të mëtejshëm, duke përcaktuar profile specifike të programit në fushat “civile” dhe “tregtare”, element i cili do t’u jepte studentëve mundësinë e një formimi më të thelluar.
5. Gjithashtu emërimi në mënyrë periodike të ekspertëve të jashtëm, të cilët do të bënin një vlerësim të pavarur të programit të studimit dhe të programeve të lëndëve mësimore, do të përbënte një vlerë të shtuar në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkruese

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është një prej tre fakulteteve që përbejnë UMSH i përbërë nga tre departamente (ref. Tabela 1):

Departamenti i të Drejtës Civile

Departamenti i të Drejtës Publike

Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Fakulteti ka si qëllim zhvillimin akademik të çdo studenti për në funksion të problematikave aktuale juridike në shoqëri dhe pajisjen e studentëve me aftësitë teknike në fushat e studimit. Gjithashtu, fakulteti punon për zhvillimin e kërkimit shkencor në fushën e drejtësisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Aktualisht, Fakulteti ofron 2 programe studimi të Ciklit të Parë (BA); 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 1 program të Ciklit të Dytë Master Profesional me dy profile(MP). Përmbushja e kësaj detyre mundësohet përmes angazhimit të një personeli akademik të përbërë nga 41 pedagogë, nga të cilët 28 të brendshëm dhe 13 të jashtëm.

Programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare ka si qëllim kryesor formimin dhe diplomimin e juristëve në fushën e të drejtës civile dhe tregtare dhe të promovojë kërkimin shkencor në këtë drejtim. Personeli mësimdhënës ndahet në personel akademik efektiv (me kohë të plotë / PAE) dhe personel akademik me kontratë (me kohë të pjesshme / PAK). Drejtuesit e njësisë bazë dhe dekanatit janë pedagog të brendshëm dhe punojnë me kohë të plotë në institucion.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Stafi akademik i departamentit të së Drejtës Civile me kohë të plotë dhe të pjeshme përbëhet nga pedagog me tituj dhe grada shkencore, konkretisht, 2 profesor të asociuar, 6 doktorë, 5 me MSC, një pjesë prej të cilëve janë në proces doktorature (ref. Tabela 1.1 RVB). Në programin e studimit Msc. “E Drejtë Civile dhe Tregtare” programi MSc i ofruar është një i vetëm, pa orientime në profile. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton ndryshime të vogla në përbërjen e stafit akademik ndër 2 vitet akademike që janë objekt i këtij riakreditimi (2017-2019). Këto ndryshime janë bërë duke ruajtur standardet akademike në lidhje me titujt dhe gradat shkencore që stafi akademik efektiv duhet të ketë.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë që me krijimin e tij ka pasur si mision kryesor edukimin e brezit të ri dhe rritjen e kërkimit shkencor.</p> <p>Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, institucioni është organizuar dhe funksionon në bazë të kërkesave ligjore dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërje tre departamente që funksionojnë si njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Departamenti i të Drejtës Publike;</li><li>• Departamenti i të Drejtës Civile;</li><li>• Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</li></ul> <p>Secila prej këtyre njësive bazë, funksionon në përputhje me objektivat dhe misionin e tyre. Këto njësi, e kanë përqendruar aktivitetin e tyre, në realizimin e synimeve, strategjive të njësive kryesore, duke bashkërenduar dhe punën ndërmjet tyre.</p> <p>Departamentet kanë në përbërjen e tyre më shumë se 7 anëtarë efektiv si personel akademik dhe më shumë se 3 anëtarë të personelit me gradën shkencore “Doktor” në përputhje me SSHC.</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në drejtimin e njësive bazë dhe kryesore është zgjedhur personel akademik me përvojë të gjatë akademike dhe personalitete të njohura të fushës. Në përputhje me rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare neni 6 shefi i departamentit është përgjegjës për programin e studimit Siç u evidentua gjatë vizitës së</p>

GVJ, Departamenti zhvillon mbledhje të përjavshme, zakonisht ditën e mërkurë, në lidhje me çështjet dhe problematikat e ndryshme që lidhen me mbarëvajtjen e zhvillimit të programeve të studimit.

Departamenti si njësi bazë propozon kërkesat kualifikuese dhe profilin profesional të pedagogëve që do të angazhohen në programin, në përputhje me ngarkesën mësimore dhe profilin e lëndëve që ofrohen në këtë program studimi. Përgjegjësi i departamentit bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit gjatë vitit akademik. Gjatë vizitës së institucionit, GVJ u njoh me dosjet e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.

Mbështetur në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” rezulton se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit. Kriteret bazë përcaktohen nga njësi përgjegjëse dhe miratohen nga ana e Rektorit. Me pas është Rektori i cili ngrë komisionin që zhvillon procedurën e konkurrimit. Ky i fundit jep edhe miratimin final. Sipas RVB-së Përgjegjësi i Departamentit është anëtar i këtij komisioni.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Sipas akteve rregulluese të UMSH rezulton se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit dhe kriteret bazë të përcaktuara nga njësi përgjegjëse. Këto kritere më pas miratohen nga autoriteti më i lartë drejtues i Institucionit (Rektori).
2. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ku çdo fakultet përbëhet nga tre njësi bazë. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërje tre departamente, përkatësisht, Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
3. Në Departamentin e të Drejtës Civile ku është organizuar programi i studimit Master i Shkencave “E Drejtë Civile dhe Tregtare” për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 12 anëtarë të personelit akademik, ndër të cilët me kohë të plotë (PAE) 9 pedagogë, ndërsa me kontratë (PAK) 3 pedagogë. Për vitin paraardhës 2017-2018 janë 11 anëtarë të personelit akademik, ndër të cilët me kohë të plotë (PAE) 8 pedagogë, ndërsa me kontratë (PAK) 3 pedagogë
4. Për vitin akademik 2017-2018, nga 11 pedagogët efektivë: 4 prej tyre kanë gradën shkencore dhe titullin akademik “Prof. Asoc” dhe 7 prej tyre kanë gradën shkencore (Dr). Për vitin akademik 2018-2019 nga 12 pedagogët efektivë, 5 prej tyre kanë gradën shkencore dhe titullin akademik “Prof. Asoc” dhe 7 prej tyre ka gradën shkencore (Dr).

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkuese

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Për realizimin e programit të studimit, Institucioni ka angazhuar një staf akademik të përbërë me personel akademik efektiv (PAE) dhe personel akademik me kontratë (PAK). Personeli akademik efektiv përbëhet nga drejtuesit dhe stafi akademik i brendshëm. Personeli akademik me kontratë përbëhet nga stafi akademik i jashtëm dhe lektorët e ftuar.

Personeli akademik i Departamentit të së Drejtës Civile ndahet në tre kategori: personel akademik, personel ndihmës mësimor-shkencor dhe personel administrativ. Për sa i përket personeli akademik, ata kryejnë veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbime në zhvillim të institucionit, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative. Departamenti përbëhet nga 13 anëtarë të personelit akademik. Për sa i përket raportit midis gjinive, për programin e studimit, rezulton se anëtarë PAE janë 3 anëtarë meshkuj dhe 7 anëtare femra. Ndërsa nga anëtarët PAK, janë 1 anëtar mashkull dhe 2 anëtare është femra (ref. Tabela 1.1 RVB).

Në programin e studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 12 anëtarë të personelit akademik. Përsa i përket raportit midis gjinive, për programin e studimit, rezulton se anëtarë PAE janë 6 anëtarë meshkuj dhe 3 anëtare femra. Ndërsa nga anëtarët PAK, janë 2 anëtarë meshkuj dhe 1 anëtare është femër (ref. Tabela 3 RVB).

Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës për njoftimit, procedurën e rekrutimit, lidhjen e kontratës e termat e saj etj. Rregulla mbi mënyrën e përcaktimit të nevojave për punësim, autoriteteve që përcaktojnë kriteret ngritjen e komisioneve ad-hoc e kompozimin e tyre gjenden edhe ne Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. Rekrutimi i punonjësve të rinj realizohet nga një komision ku marrin pjesë Rektori, Dekani dhe/ose përgjegjësi i departamentit dhe një përfaqësues i Qendrës “Mesdheu”. Përparësi i jepet personelit më të kualifikuar në titujt e grada dhe edukim në universitete të huaja.

Nga verifikimi dhe konstatimet në institucion rezulton se të gjithë anëtarët kanë kontrata të rregullta dhe të plota si edhe njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela 2 në Aneks)

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike, ku çdo fakultet përbëhet nga tre njësi bazë. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare ka në përbërje tre departamente, përkatësisht, Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënies Ndërkombëtare.

Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor zotëron kualifikimet e duhura për qëllimet e përmbushjes së detyrave përkatëse. Titullarët e lëndëve janë të gjithë më grada e tituj. Personeli i programit është pjesë e Departamentit të Shkencave Juridike e si rrjedhim është në kontakt e shkëmbim akademik në radhë të parë me personelit tjerët të Departamentit dhe të 2 departamenteve të tjera më afërsi në fushën e studimit si Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Për vitin 2017/2018, personeli efektiv është në masën e rreth 72% titullarëve të lëndëve të programit; titullarë janë personel më grada e tituj. Raporti i pedagogëve efektive (PAE) me pedagogët me kontratë (PAK), në kategorinë e titullit Prof. Asoc. është 3/1, në kategorinë Doktor është 5/2.

Për vitin 2018/2019, personeli efektiv është në masën e rreth 75% titullarëve të lëndëve të programit; titullarë janë vetëm personel më grada e tituj. Raporti i pedagogëve efektive (PAE) me pedagogët me kontratë (PAK), në kategorinë e titullit Prof. Asoc. është 4/1, në kategorinë Doktor është 5/2.

Nga këto të dhëna të konstatuara nga GVJ në RVB dhe nga vizita në Institucion, ka një trend përmirësues në kualifikimin e stafit pedagogjik.

Nga dokumentacioni shtesë i kërkuar nga GVJ rezulton se ngarkesa mësimore referuar këtij programi rezulton në 640 orë mësimore, nga të cilat 630 mbulohej nga PAE dhe 210 nga PAK, duke u mbuluar kështu 75% e ngarkesës nga PAE.

Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion gjatë vizitës, rezulton se pedagogët nuk mbulojnë më shumë se tre lëndë,

Të dhëna të tjera në lidhje me moshën, grada e titujt sipas kategorive, është i identifikuar në tabelat në Aneksin e Raportit.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Institucioni rezulton të ketë një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillimin normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve në favor të studentëve.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i departamentit të së Drejtës Civile bashkëpunon dhe kontribuon në realizimin dhe zbatimin e strategjisë për zhvillimin e UMSH.
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të	Personeli akademik ka përgjegjësinë kryesore për hartimin e kurrikulës. Procesi i hartimit dhe miratimit të kurrikulave është bazuar tek parimet dhe kriteret

<p>programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënljgore në fuqi.</p>	<p>akademike të përcaktuara në aktet ligjorë dhe nënljgore për arsimin e lartë, udhëzimet e ASCAL-it, Statuti dhe Rregullorja e Institucionit. Nga ana procedurale procesi i organizimit dhe diskutimi i kurrikulave për ciklet e studimeve që ofrohen realizohen në departament si njësi bazë.</p> <p>Për programin e studimit MSC në E Drejtë Civile dhe Tregtare në nivel departamenti secili nga pedagogët jep argumente shkencore mbi syllabusin e përgatitur. Nga verifikimi në institucion, rezultojnë që zhvillohen mbledhje javore të anëtarëve të Departamentit ku diskutohen mundësitë e përmirësimit të mëtejshëm të programeve mësimore.</p> <p>Sipas Statutit dhe Rregullores organizative të UMSH-së rezultojnë se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrencës. Sipas RVB-së kërkesat bazë përcaktohen nga njësi përgjegjëse dhe miratohen nga ana e Rektorit. Më pas është Rektori i cili ngrë komisionin që zhvillon procedurën e konkurrencës. Përgjegjësi i Departamentit është anëtar i këtij komisioni. Nga këto të dhëna rezultojnë se rekrutimi i personelit bëhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto procedura i janë evidentuar GVJ-së gjatë vizitës në Institucion, edhe në kuadrin e përmirësimeve ndaj akreditimit të parë të programit para dy vitesh.</p>
<p><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>-Rekrutimi i personelit akademik bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënljgore në fuqi si dhe bazuar në kriteret e parashikuara në statutin dhe rregulloren e Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë. Procedura e rekrutimit të stafit akademik është e hapur dhe transparente, siç është edhe evidentuar në shpalljet publike në <i>website</i>-in e Institucionit.</p> <p>Para fillimit të çdo viti akademik, njësi bazë, për të plotësuar nevojat e saj në realizimin e programit të studimit, në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore, përcakton kërkesat për personel akademik me kohë të plotë ose të pjesshme. Kërkesa për rekrutimin e stafit akademik, miratohet nga Dekani dhe Rektori. Vetëm pas këtyre hapave thirrja publikohet online në faqen zyrtare të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”, në median elektronike dhe të shkruar. GVJ ka kërkuar evidencë të kësaj procedure e cila është vënë në dispozicion nga Institucioni</p>

-Në nivel numerik, për vitin 2018-2019, personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë MSC në E Drejtë Civile dhe Tregtare përbën 75% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve (9 PAE dhe 3 PAK). Për vitin 2017-2018 personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë MSC në E Drejtë Civile dhe Tregtare përbënte 72% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve (8 PAE dhe 3 PAK).

Duke iu referuar numrit të orëve, gjithnjë përqindja mbetet e pandryshuar. Nga dokumentacioni shtesë i kërkuar nga GVJ rezulton se ngarkesa mësimore referuar këtij programi rezulton në 640 orë mësimore, nga të cilat 630 mbulohen nga PAE dhe 210 nga PAK, duke u mbuluar kështu 75% e ngarkesës nga PAE.

Përsa i përket vlerësimit të personelit, UMSH ndjek një procedurë vlerësimi për personelin akademik i cili përfshin të dhënat që vijnë nga vetëvlerësimi për punën dhe aktivitetin në IAL, vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit, vlerësimi i dekanit të fakultetit, vlerësimi i administratorit dhe pyetësorët e studentëve. Të gjitha këto vlerësime, realizohen me mbështetjen e NJSBCKZH, dhe u bëhen me dije personelit nga drejtuesi direkt i tij në fund të çdo viti akademik. Të gjitha këto të dhëna bëhen pjesë e një analize vjetore.

- UMSH disponon një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit si dhe njoftimeve për vende vakante pune. Baza e të dhënave të personelit akademik u verifikua nga GVJ gjatë vizitës në Institucion.

**Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.**



<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit “Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare” ka titullin shkencor “Profesor i Asociuar”.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>Titullarët e lëndëve në programin e studimit, për vitin akademik 2018-2019, “Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare”, nuk ka titullarë me titullin “Profesor”, 5 me titullin “Profesor i Asociuar” (4 PAE dhe 1 PAK) dhe 7 me gradën “Doktor” (5 PAE dhe 2 PAK). Sipas pikes 3 te nenit 56 te LAL 80/2015, titullarët e lëndëve duhet të jenë të kategorisë Profesorë të Asociuar ose Profesorë, kështu që kjo pikë rezulton pjesërisht e papërbushur, duke qenë se, nga 12 lëndë të programit, në tetë prej tyre titullarët mbajnë gradën shkencore “doktor”.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p>	<p>Autoritetet drejtuese rezultojnë me tituj akademik, duke qenë njëkohësisht personalitete me kontribut në fushën shkencore të analizuar. Rezultojnë të angazhuar me kohë të plotë në Institucion.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p>Për sa i përket praktikave profesionale, Institucioni ka një procedurë e cila i siguron vetë studentit mundësinë për të zgjedhur vetë vendin e realizimit të praktikës profesionale, duke i ofruar mundësinë që të aksesojë Institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Sipas dokumentacionit të administruar gjatë vizitës në institucion rezulton se si pedagog mbikëqyrës është vetëm një. Duke pasur në konsideratë numrin e studentëve si edhe standardet shtetërore, rezulton se ky kriter duhet përmirësuar.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p>	<p>-Referuar RVB-së dhe nga verifikimi në institucion (takimet me personelin akademik dhe me studentët) rezulton se studentët që në fillim parashtrajnë fushën në të cilën do të realizojnë tezën për marrjen e diplomës. Gjithashtu në çdo rast sigurohet edhe pedagogu udhëheqës. Nga takimet në IAL rezulton se me studentët zhvillohen edhe seanca metodologjike, në lidhje me detyrimet që ato kanë në këtë program studimi, detyrave që duhet të realizojnë, si edhe tezën që duhet të mbrojnë në fund të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>- Udhëheqësit e punimeve të diplomës në programet e studimit master i shkencave, në E Drejtë Civile dhe Tregtare kanë së paku të paktën gradën Dr.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>-Nuk ka staf akademik që drejton më shumë se 10 studentë, siç u konstatua edhe nga GVJ në Institucion. Maksimalja në numrin 5 e referuar në RVB rezulton të jetë gabim, duke qenë se edhe rregullorja e UMSH-</p>

	së përcakton në 10 numrin maksimal të udhëheqjeve.
<b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Duke pasur parasysh kufizimet sasiore të përcaktuara nga aktet normativë dhe sipas informacionit të marrë në institucion, lista e pedagogëve ka vëmendjen e nevojshme nga njësia bazë në shpërndarjen e pedagogëve mbikëqyrës të temave të kërkimit sipas fushës studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi.</p> <p>- Të gjithë udhëheqësit kanë njohuri të avancuara dhe të thelluara për zhvillimin e kërkimit dhe hartimin e tezës për këtë program studimi.</p>
<b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>- Nisur nga natyra e këtij program studimi, rezultun se nga ana e institucionit, është vënë në dispozicion personeli i bibliotekës së Universitetit, sekretaria mësimore si edhe lektorët. Po kështu edhe mirëmbajtja e këtyre ambienteve realizohet nga personeli përkatës.</p> <p>- Nga ana e Institucionit rezultun se ka një personel të mjaftueshëm akademik dhe ndihmës akademik i cili mundëson zhvillim normal të procesit të mësimdhënies si edhe realizimin e shërbimeve në favor të studentëve. Nga verifikimi i GVJ rezultun se disa pedagogë mbulojnë disa detyra administrative dhe po ashtu nga stafi administrativ mbulohen më shumë detyra.</p>
<b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>- Sipas informacionit të marrë në institucion e në konsultim me kontratat e punës rezultun që në lidhje si me personelit akademik të brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm ndiqen rregullimet në fuqi (deri në kohën e këtij vlerësimi) në lidhje me normën e ngarkesës mësimore. Udhëzimi nr. 29, i datës 10.09.2018 i Ministrisë të Arsimit parashikon një sasi orësh dhe lëndësh më të limituar se parashikimet rregullative të UMSH. Megjithatë, duke u bazuar në ngarkesën që na ka dhënë IAL për stafin akademik të angazhuar në këtë program stumi rezultun se një pedagog mbulon 1 deri në 3 lëndë.</p> <p>- Ngarkesat mësimore gjenden të pasqyruara në miratimin e planit mësimor për çdo vit akademik me</p>

	pedagogët përkatës për çdo lëndë, mbështetur në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 20 si dhe Rregulloren e Fakultetit FSHJMN. Ngarkesa mësimore dhe organizimi e drejtimi i tyre për programin e ciklit të dytë të studimit, vlerësohet me orë mësimore siç është evidentuar nga Institucioni nëpërmjet dorëzimit të dokumenteve shtesë të kërkuara nga GVJ.
<b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	<p>- Nga kontrolli në Njësinë e Burimeve, rezultoi se të gjithë anëtarët e personelit akademik kishin dosjen e tyre personale në të cilën gjendeshin Dokumenti i identitetit, Dokumenti që vërteton punën e kryer më parë, Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore, Diploma Universitare dhe lista e notave, Diploma dhe dokumente të tjera te gradave dhe titujve shkencorë, si dhe të kualifikimeve të tjera, Libreza shëndetësore, Adresa e vendbanimit, Lista e botimeve, artikujve dhe kërkimeve shkencore.</p> <p>- Nga RVB si edhe nga verifikimi në institucion, në departament dhe në njësinë e burimeve njerëzore rezultoi se Fakulteti dhe njësitë bazë disponojnë listën e plotë të personelit akademik.</p> <p>- Në drejtim të kriterëve dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, ato janë të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Institucionit. Thirrjet janë publike në përmbushje të kërkesave të kuadrit ligjor në fushën e arsimit të lartë dhe kërkesave të Kodit të Punës.</p>
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit rezultojnë me eksperiencë dhe kualifikime të rëndësishme për qëllimet e përmbushjes së detyrave përkatëse. Megjithatë rezultoi se titullarët në disa raste janë me grada shkencore, gjë që nuk përputhet me LAL 80/2015 (neni 56).</li> <li>2. Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi Msc. "E Drejtë Civile dhe Tregtare" për vitet akademike 2017-2019 ka ndryshuar lehtësisht në numër duke u rritur dhe në angazhimin në realizimin e programit mësimor. Nga analiza e të dhënave që gjenden në RVB dhe nga dokumentacioni që GVJ mori gjatë vizitës në institucion, rezultoi që raportit ndërmjet PAE dhe PAK për vitet akademike 2017-2018 dhe 2018-2019 është brenda standardeve.</li> <li>3. Titullarët e lëndëve nuk janë të gjithë personel akademik efektivë edhe pse angazhimi i personelit akademik me kontratë në rolin e titullarëve të lëndëve përbëhet nga pedagogë që mbajnë tituj dhe grada shkencore.</li> <li>4. Institucioni realizon vlerësim nga ana e studentit të programit nëpërmjet aplikimit i pyetësorit dhe fokus grupeve. Vlerësimi realizohet gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë por edhe në nivel</li> </ol>	

Fakulteti e Rektorati nëpërmjet shkëmbimit interaktiv me stafin dhe vlerësimeve në fund të vitit.

5. Rezulton se disa pedagogë mbulojnë disa detyra administrative dhe po ashtu nga stafi administrativ mbulohen më shumë detyra. Këshillohet rritja e numrit stafit administrativ në mënyrë që të lehtësohen detyrat e pedagogëve të ngarkuar me këto detyra dhe e stafit administrativ aktual.
6. Rekomandohet të evidentohet më qartë procedura në konsultimin me pedagogët dhe shpërndarjen e ngarkesës në fillim të secilit semestër nga ana e Përgjegjësit të Departamentit

#### 4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### Pjesa përshkruese

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Infrastruktura e institucionit është e përshtatshme për zhvillimin efektiv të programit mësimor dhe funksioneve mbështetëse. Është e shtrirë në një sipërfaqe prej 3860 metër katrorë; përmban aula në madhësi 100-120 vende në sipërfaqe 110metër katror, salla leksionesh e seminaresh, laboratorë etj. Sallat janë të pajisura me ndriçim e aksesore të duhur teknologjie për zhvillimin normal të aktivitetit përkatës, ndërkohë që rreth 50% e hapësirës anësore të të gjitha sallave është me dritare e ballkon me ajrosje e dritë.

Ambientet e institucionit janë të përshtatshme për aktivitetin e mësimdhënies dhe aktivitetet ndihmëse. Laboratorët kompjuterike kanë kapacitet në me rreth 35- 40 vende, bibliotekë me 4162 tituj librash, prej të cilave rreth 1800 tituj në fushën e drejtësisë, me një hapësirë prej 104 dhe 107 metër katrorë dhe rreth 25- 30 vende leximi të hapur, përfshirë edhe jashtë sallës qendrore të bibliotekës (pjesë parahyrëse ).

Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike; gjithashtu katalogu elektronik është i mundur për studentët online për kërkim individual. Godina ka shërbim interneti wifi 24 orë. Biblioteka Online e UMSH-së ka mbi 327,325 tituj librash.

Hapësirat janë të pajisura me ndriçim alternativ në rast ndërprerje të energjisë elektrike; gjithashtu në çdo kat të godinës janë të instaluar pajisjet mbrojtëse kundër zjarrit.

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

	Sasia	Sipërfaqja
Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit		
Salla për leksione	6	563.5
Klasa për seminare	15	598.1
Salla për aktivitete promovuese	1	104
Laboratorë informatike	3	144
Salla internet	1	52
Salla për bibliotekë	4	157
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	15
Zyrë informacioni për studentët	1	14
Korridore/holle	10	680
Mjedise sportive		-----

Mjedise shërbimi për të tretë	-----	
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	2	102
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	430
Nyje hidrosanitare për studentët	53	203.4
Norma m <sup>2</sup> /për student		5.395

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Rektoratin/Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	7	170.5
Zyra për sekretarinë mësimore	3	48
Zyra për departamentet/Qëndrat kërkimore-shkencore/Zyra ZKSK/Marrëdhëniet me jashtë	8	262.6
Zyra për personelin akademik	2	52.6
Zyrë për financën	1	30
Zyrë për Njësinë e SBC	1	25.5
Salla për mbledhje	1	58
Mjedis për stafin e shërbimit	2	64
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	5	25.8
Arkiva	2	50
Norma m <sup>2</sup> /për person		5.1

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni i përmbush kënaqshëm kërkesat në lidhje me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve; spikat në cilësinë e mjediseve, përshtatshmërisë së sallave të leksioneve, aksesit të lehtë të studentëve etj. Ka një vendndodhje të qëndrueshme që përfshin si mjedisin qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Gjithashtu rezulton se këto mjedise janë në dispozicion të institucionit me qira për një afat 10 vjeçar.</p>
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>-Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës dhe nga takimi që zhvilloi me drejtuesen e kësaj biblioteke, GVJ u njoh me literaturën e disponueshme për këtë program studimi. Institucioni ka siguruar një literaturë të pasur, në ndihmë të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve kërkimorë-shkencorë, e cila është vendosur dhe sistemuar në Bibliotekën e UMSH. Në fushën e së drejtës civile dhe tregtare rezultojnë rreth 646 materiale (libra, revista, artikuj shkencor etj.) si dhe një librari elektronike me 20.849 tituj, abonim ne <a href="http://www.questia.com">www.questia.com</a> si dhe “The economist” me një fond të rëndësishëm, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës. Biblioteka dhe salla e studimit ndodhet në brenda të godinës së Universitetit dhe është lehtësisht e aksesueshme për studentët, pedagogët dhe studiuesit. Në Rregulloren e Organizimit të UMSH ne nenin 30 të saj, sanksionohet se Biblioteka është njësi ndihmëse e Institucionit. Kjo njësi ofron shërbim për të nxitur punën kërkimore shkencore si për stafin akademik ashtu dhe për studentët.</p> <p>- Nga IAL ndiqet një procedurë vjetore e pasurimit të bibliotekës bazuar në kërkesat që bëhen në fillim të çdo viti nga ana e stafit akademik.</p> <p>-Gjithashtu gjatë vizitës në institucion u vendos në dispozicion edhe një praktikë e pasurimit të bibliotekës, blerjet e bëra si edhe një listë me literaturën që gjendet në bibliotekë. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezultoi se IAL nuk dokumenton literaturën për çdo program studimi por e ka të individualizuar atë mbi bazë fakulteti. Megjithatë gjatë vizitës në institucion, por edhe analiza e dokumentacionit të paraqitur rezultoi se literatura që mbështet programin e studimit, ajo e deklaruar në kurrikulat e lëndëve, është pjesë e fondit të bibliotekës dhe plotësisht e aksesueshme.</p> <p>- Biblioteka ka orare të përshtatshme të shërbimit të lidhura me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>- Nga vëzhgimi që gjatë vizitës në institucion GVJ realizoi, vlerësohen të përshtatshme të gjitha ambientet ku zhvillohet procesi i mësimdhënies. Në godinë janë vendosur laboratorë, salla studimi, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura dhe kërkimit shkencor.</p> <p>- Një faqe muri është e tëra xham, duke garantuar hapësirë të mjaftueshme drite në auditor. Të gjitha sallat janë të pajisura me sistem audioviziv komunikimi. Sallat e leksioneve janë të ndërtuara në formë amfiteatri.</p> <p>Në të gjitha hapësirat e UMSH/së ka shërbim interneti të vazhdueshëm, me 2 laboratorë PC për studentët, me rreth 60 PC.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në funksion të programit Msc “E Drejtë Civile dhe Tregtare” janë në dispozicion ambiente të përshtatshme akademike si dhe studimore, të cilat mundësojnë realizimin e qëllimit të këtij programi.</li> <li>2. Biblioteka dhe salla e studimit është lehtësisht e aksesueshme për studentët, pedagogët, studiuesit dhe gjithë palët që kanë interes të drejtpërdrejtë. Institucioni ka siguruar një literaturë të pasur, në ndihmë të studentëve dhe pedagogëve sidomos nëpërmjet abonimeve on-line.</li> <li>3. Sallat dhe mjediset në të cilat zhvillohej aktiviteti akademik si dhe pajisjet infrastrukturore në dispozicion vlerësohen të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet dhe nevojat e zhvillimit të procesit të mësimdhënies.</li> </ol>	

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**  
**Pjesa përshkruese**


**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sipas dokumentacionit të institucionit, burimet e të ardhurave janë kryesisht tarifat e studentëve në masën 98% në vitin 2017-2018 dhe në vitin 2018-2019 të programit Master Shkencor, ndërkohë që respektivisht rreth 2% vitin e parë dhe vitin e dytë të programit Master Shkencor është siguruar nga aktivitetet tregtare (rreth 0,5%) dhe nga grante kërkimore-shkencore (rreth 1,5%). Të ardhurat nga grantet kërkimore-shkencore rezultojnë të jenë një risi në elementin e të ardhurave të Institucionit në krahasim me akreditimin e fundit të programit.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim - 1,5%



- Konsulencat, shërbimet - nuk ka
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit - 98%
- Sponsorizimet - nuk ka
- Shërbime trainuese etj. - nuk ka
- Donacione aktivitetet siguruese, fondacione etj. - nuk ka
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat etj.) - 0,5 %

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Sipas informacionit në institucion dhe atij të dorëzuar, veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm që realizohet nga një kompani auditimi e certifikuar; në Raport paraqitet e gjithë situata financiare e përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të ofruara. Përveç auditimit të jashtëm realizohet edhe auditim i brendshëm në lidhje me përdorimin e burimit të të ardhurave, përmbushjen e qëllimeve të tyre etj. Në referim të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë burimet kryesore të të ardhurave janë kontributet nga studentët dhe të themeluesve të Qendrës. Bordi i Qendrës kërkon informacione ditore dhe mujore në lidhje me mënyrën e përdorimit të të ardhurave sipas një procedure të paracaktuar në Rregulloren e Qendrës Mesdheu. Sipas Raportit drejtimet e shpenzimeve përqendrohen në përmirësimin e trajtimit të personelit akademik, përmirësimin e infrastrukturës në lidhje me kushtet e punës, mësimdhënien, hapësirat për studentët, pasurimit të burimeve të informacionit, zgjerimi të literaturës së bibliotekës etj.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni është themeluar nga Qendra Mesdheu, subjekt i Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për Organizatat Jo Fitimprurëse”, i ndryshuar. Ky element rezulton në përputhje me standardet ligjore të ligjit për arsimin e lartë.</p> <p>Në bazë të statutit dhe rregullores organizative harton raporte të përvitshme financiare të detajuara të cilat i paraqiten Bordit në çdo vit. Administratori i Universitetit çdo vit harton projektbuxhetin vjetor dhe atë afatmesëm mbi bazën e propozimeve të njësisve kryesore dhe të njësisve bazë, propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit.</p> <p>Në kushtet aktuale UMSH reflekton një qëndrueshmëri financiare që siguron për mbështetjen e programit të studimit Master Shkencor</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. GVJ, duke u bazuar dhe tek të dhënat e pasqyruara në RVB konkludon që menaxhimi i burimeve financiare është konform standardeve të kërkuara dhe qëllimit të veprimtarisë së institucionit.</li> <li>2. Mbajtja e pasqyrave financiare rrit transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.</li> <li>3. Realizimi vjetor i auditimeve financiare nxit eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat e tjera në funksion të rritjes së kapaciteteve mësimdhënëse dhe kërkimit shkencor si dhe të cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</li> </ol>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkruese

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sipas nenit 28 të Rregullores Organizative të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është strukturë ndihmëse në UMSH në funksion të zbatimit të politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe varet nga Rektori i UMSH. NJSBCZHK ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit. Kjo strukturë është e përbërë nga 7 anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga secila prej njësisve kryesore të Universitetit. Objektivat e punës së kësaj njësie lidhen me zbatimin e metodave të vlerësimit dhe të vetëvlerësimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së institucionit. Pjesa

qendrore e vlerësimit të performanës akademike e profesionale bazohet në formularë tip të depozituar në dokumentacionin e vlerësimit.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Instrumentet e parashikuar nga Rregullorja dhe të përdorur përgjatë programit Msc “E Drejtë Civile dhe Tregtare” janë si më poshtë:

I. Kalendarët semestralë të Kontrollit të Cilësisë - Për të planifikuar punën lidhur me kontrollin e cilësisë, gjatë vizitës në institucion, intervista e realizuar me GVB si edhe me drejtuesin e NJSBZHK, GVJ u informua se NJSBZHK harton kalendarin e kontrollit të brendshëm të cilësisë për programet mësimore për çdo vit akademik. Sipas këtij kalendari, në bashkëpunim edhe me departamentet ushtrohet aktiviteti i monitorimit të procesit mësimor në tërësi.

II. Hartimi dhe plotësimi i Pyetësorit për Studentët - Pyetësori hartohet nga NJSBZHK dhe plotësohet në mënyrë anonime nga studentët; ai plotësohet në përfundim të çdo semestri, pra 2 herë në vit dhe përmban jo vetëm pyetje për pedagogët, por edhe për çështje të tjera, që lidhen me leksionet, komunikimin student-pedagog, infrastrukturën mësimore, për të marrë mendime për aspektet kryesore të zhvillimit të performancës dhe cilësisë, etj.

III. Intervistat me studentët - Intervistat apo takimet jo formale me studentët në formën e fokus grupeve, zhvillohen me qëllim që të diskutohet për procesin mësimor në përgjithësi dhe për probleme të veçanta që ata hasin përgjatë procesit mësimor.

IV. Vlerësimi nga Përgjegjësi i Departamentit – Drejtuesi i njësisë bazë në periudha periodike kontrollojnë procesin e mësimdhënies së pedagogëve nëpërmjet shkëmbimit interaktiv.

Njësia në bazë të pyetësorëve dhe anketimeve përgatit raporte të ndryshme dhe ia paraqet ato autoriteteve drejtuese. Të dhënat e raporteve janë një nga elementët për vlerësimin e stafit akademik. Pedagogët njihen individualisht me këto të dhëna.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Institucioni përdor kryesisht metodat e vlerësimit sasior dhe cilësor në vlerësimin e ecurisë së programit studimor Master i Shkencave “E Civile dhe Tregtare”; sasior lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga pedagogët dhe studentët dhe cilësor pasi analizon proceset e mësim-dhënies/mësim-nxënies, analizon praktikat e ndjekura në vlerësim, përmirëson komunikimin student-pedagog, etj. - Të dhënat i vihen në dispozicion autoriteteve drejtuese dhe janë objekt analize në nivele departamenti. - Sipas karakterit të informacionit, vlerësohet edhe
<b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	
<b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit,	

<p>përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>mundësia e publikimit të tyre.</p> <p>- Nga vizita në institucion, komunikimi me anëtarët e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe takimet e drejtpërdrejta me pedagogët e studentët por edhe nga konsultimi në vend i formularëve të pyetësorëve, formularëve të vlerësimit, raportet e përpiluara nga njësia bazë por edhe raportet e fakultetit dhe rektoratit, rezultatet e studentëve dokumentacioni i praktikës, rezultoni se Njësia e mat ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi nëpërmjet përdorimit të instrumenteve matëse dhe vlerësuese, të tërthorta apo të drejtpërdrejta, të tilla si: pyetësorë për studentët, raporte të njësive kryesore e njësive bazë, vlerësime për pedagogët të nivelit të njësisë por edhe Fakultetit apo rektoratit, vlerësues për praktikën- raportin e pedagogut, rezultatet e detyrave të studentëve, testimeve paraprake, provimeve pjesore, feedback nga personeli drejtpërdrejtë duke përfshirë gjithashtu edhe studentët dhe stafin administrativ, dëgjime në auditor nga grupe të Fakultetit apo Rektoratit, etj. Pjesë e vlerësimit është edhe aspekti i punës ndihmëse mbështetëse pranë njësive bazë për qëllime të përmbushjes së objektivave të procesit akademik etj.</p>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Nga kontrolli, që realizoi vetë GVJ, rezultoni se <i>institucioni nuk publikon në faqen e vetë të internetit raportet e vlerësimit të brendshëm të realizuar nga vetë institucioni.</i></p> <p>Institucioni përpunon një raport mbi vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihat në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar në formën e broshurave promovuese të programeve dhe cilësisë që ato ofrojnë.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	

**Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Gjetjet e NJSBCZHK institucioni i zhvillon në formën e diskutimeve në nivel Senati, Fakulteti dhe Departamenti. Në këto nivele diskutohet me tej për dobësitë e konstatuara dhe për ecurinë e programeve, si edhe për përmirësimin e tyre.

- Konkluzionet e arritura nga strukturat e Institucionit, pasohen në hartimin e politikave që kanë si qëllim përmirësimin e programit të studimit.

**Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Institucioni i SHLP Mesdhetare është licencuar në vitin 2009 dhe në vitin 2012 nëpërmjet Urdhrave 124/2012 dhe 291/2012 të Ministrit të Arsimit është akredituar institucionalisht për herë të fundit në vitin 2017.

Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBCZHK, tërheqjes së mendimit të studentëve, të ish studentëve, bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore.

Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të NJSBCZHK dhe reflektohet në format dhe formatet standarde në UMSH.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Institucioni përmbush detyrimet e vlerësimit të sigurimit të cilësisë së brendshme nëpërmjet Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave
2. Njësia mat ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur një metodologji me instrumente matëse dhe vlerësuese të tilla si: pyetësorë për studentët, raporte të njësive kryesore e njësive bazë, vlerësime për pedagogët të nivelit të njësisë por edhe Fakultetit apo rektoratit, vlerësues për praktikën, etj.
3. Metodologjia e vlerësimit, instrumentet matëse dhe vlerësuese janë të shpjeguara në Raportin e Vetëvlerësimit që bën Njësia për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë, dhe gjithashtu objekt i shqyrtimit dhe adresimit të detyrave përkatëse nga ana e autoriteteve drejtuese brenda Institucionit.
4. Institucioni nuk cakton ekspertë të jashtëm për verifikimin e gjendjes së punës. Analiza e një eksperti të jashtëm do të mundësonte rekomandime të mëtejshme për metodologjinë e mësimdhënies, të kontrollit të njohurive, përmirësimin e tyre, përshtatjen e metodave të reja në

gërshetim me teknikat/metodat tradicionale, dhe çdo komponent tjetër në funksion të rritjes së cilësisë dhe shkëmbim të praktikave të mira.

5. *GVJ rekomandon një transparencë më të madhe në lidhje me të gjitha proceset e brendshme të zhvillimit të institucionit, sidomos në kuadrin e publikimeve on-line.*

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkruese

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit, qëllimi dhe misioni i programit të studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare është të pajisë studentët me njohuri themelore për formimin e tyre si specialistë në fushën e të drejtës civile dhe asaj tregtare, të aftë për të kontribuar në zhvillimin e drejtësisë, në aspektin e përmirësimit të legjislacionit, si dhe përgatitjen e kapaciteteve njerëzore, ekspertëve, analistëve, studiuesve të shkencave juridike (në fushën civile dhe tregtare).

Programi i studimit shtrihet në një nga degët e ndarjes së madhe të së drejtës, fushën e të drejtës civile (të drejtës private), konkretisht, më gjerësisht në fushën e të drejtës së detyrimeve si një nga nëndegët e saj të mëdha, duke u fokusuar më ngushtësisht dhe thellësisht në fushën e të drejtës tregtare. Disiplinat janë ngushtësisht të ndërthurura, në varësi dhe sinkron me njëra tjetrën duke qëndruar së bashku si në kuptimin shkencor ashtu edhe atë didaktik. Referuar përmbajtjes së plan programit të përgjithshëm mësimor dhe programeve të lëndëve një vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimeve aktuale të së drejtës së Bashkimit Europian në këto fusha, duke shtuar vlerat e arsimimit të studentëve në përputhje me misionin e programit. Megjithatë, një profilizim i programit vetëm në të drejtë tregtare vlerësohet si i mundshëm referuar profilit të UMSH dhe kurrikulave aktuale, marrë në konsideratë edhe faktin se profilizimi vetëm në të drejtë civile është jo aktual, për shkak se studimet në të drejtë gjithnjë e më shumë tentojnë të specializohen dhe degëzohen më tej falë ndërhyrjeve rregullatore të posaçme të legjislatorit, duke zbehur në këtë mënyrë rëndësinë e kodifikimeve madhore tradicionale, si e drejta civile, dhe duke u dhënë përparësi rregullimeve të posaçme dhe të drejtave më shumë të mbrojtura në marrëdhëniet juridiko-civile, si p.sh. e drejtë transporti, e drejtë e sigurimeve, e drejtë e energjisë, e drejtë konsumatori, e drejtë bankare, tregje financiare etj. Ky tipar është akoma më i theksuar në të drejtën e BE ku problematike shfaqet kompetenca e organeve të BE për të rregulluar të drejtën tradicionale kombëtare private. Prandaj një specializim më specifik i përgjigjet më me rigorozitet nevojave aktuale të zhvillimit shkencor dhe shoqëror.

Viti mësimor është i organizuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi, i ndarë në dy semestra me nga 15 javë secili. Shpërndarja e ngarkesës mësimore është e ekuilibruar, ku çdo semestër ka 30 kredite. Orët brenda dhe jashtë auditorit ndonëse jo krejtësisht të barabarta ruajnë standardin ligjor të kërkuar. Studentit i lihen në dispozicion më shumë orë se gjysma e ngarkesës totale mësimore, për studim individual jashtë auditorit.

Literatura e parashikuar në *syllabuset* e lëndëve përgjithësisht gjendet në bibliotekën e Institucionit në formë të shtypur ose online. Biblioteka ishte e regjistruar në platforma online, ku studentët kishin akses gjatë kohës së qëndrimit dhe studimit në bibliotekë. Fondi i librave pasurohej edhe me kërkesë të personelit akademik.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare është hapur në bazë të Urdhrit Nr. 345 datë 17.09.2015 të Ministrit të Arsimit dhe të Sportit dhe Akredituar me Vendim BA Nr. 39, datë 19.05.2017 (kohëzgjatja 2 vite, me afat 31.07.2019).

Qëllimi i programit është dhënia e njohurive të thelluara dhe të zgjeruara në fushën e të drejtës civile dhe tregtare duke përgatitur specialistë të aftë për të nisur karrierën në këto fusha si në sektorin privat ashtu edhe atë publik, apo duke u mundësuar studentëve vazhdimin e një karriere akademike nëpërmjet studimeve më të thelluara kërkimore doktores, duke rritur mundësitë për sukses profesional në tregun e punës.

Sipas Strategjisë së Zhvillimit dhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm objektivat e programit janë dhënia e njohurive të thelluara në fushën e të drejtës civile dhe tregtare dhe rritja e nivelit të kërkimit shkencor.

Në takimet e GJVJ me drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare, u theksua nga këta të fundit se diversiteti i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi si për nga gjenerata (mosha) ashtu edhe për nga vendet e arsimit të tyre mundësonte arritjen e objektivave të programit në dhënie dhe njohurive të thelluara dhe në avancimin e kërkimit shkencor në fushat përkatëse.


- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Shih Tabelën nr. 7 në aneks)

Sipas planit mësimor të programit Master Shkencor në të Drejtë Civile dhe Tregtare plotësohen kriteret e përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

Lëndët bazë të formimit të përgjithshëm (A) zënë 12 kredite, pra 10% të të gjitha krediteve të parashikuara gjatë programit. Lëndët karakterizuese të programit (B) zënë 62 kredite të barazvlefshme me 51% të të gjitha krediteve të parashikuara gjatë programit. Lëndët interdisiplinore, integruese, me zgjedhje (C) zënë 16 kredite në program, të barazvlefshme me 13%. Lëndët plotësuese, praktikat (D) zënë 12 kredite, të barazvlefshme me 10%, ndërsa lëndët përmbyllëse, diploma (E) zë 18 kredite në të gjithë programin, pra 15%. Në mënyrën e sipërpërshkruar plotësohen krejtësisht kërkesat e vendosura në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:
- |                              |                       |                                    |
|------------------------------|-----------------------|------------------------------------|
| ▪ Për leksionet.             | 8 orë në auditor dhe  | 17 orë punë e pavarur e studentit. |
| ▪ Për Seminaret              | 11 orë në auditor dhe | 13 orë punë e pavarur e studentit. |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 20 orë në auditor dhe | 5 orë punë e pavarur e studentit.  |
| ▪ Provimi përfundimtar       | 2 orë në auditor dhe  | 23 orë punë e pavarur e studentit. |



- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara (Plotësoni Tabelën ne Aneks) Shih Tabelën 7.1. në aneksin e këtij raporti.

Vihet re një përmirësim në shpërndarjen e baraspeshuar të ngarkesës mësimore në semestra në planin mësimor të vitit 2018-2019 krahasuar me atë të vitit 2017-2018, konkretisht në kreditet e akorduara Temës së Diplomës, e cila nga 24 ECTS është reduktuar në 18 ECTS në planin mësimor të vitit akademik 2018-2019. Në këtë mënyrë plan programi vjen në përputhje me kërkesat nënligjore të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, për sa i përket përcaktimit të krediteve (ECTS).

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Sipas Tabelës Nr. 8 ne Aneks)


Përgjithësisht lëndët e përfshira në planin mësimor korrespondojnë me specializimet e personelit akademik, pavarësisht se ka tendenca të lehta për përfshirjen në mësimdhënie të personelit akademik të specializuar në fusha të përafërta si p.sh. në shkenca politike ose studime europiane pa një eksperiencë të thelluar në fushën e të drejtës përkatëse ngushtësisht. Megjithatë një angazhim i tillë nuk duket se cenon thelbësisht cilësinë, për shkak të natyrës shumëdimensionale që ka e drejta europiane.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

- Analizë e cilësisë së syllabuseve

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UMSH, si edhe nga RVB rezulton se Syllabuset e lëndëve janë të standardizuara në formë. Ato janë përshtatur me formën e përkrahur në Shtojcën 2 të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018. Përgjithësisht syllabuset pasqyrojnë një ezaurim të plotë të objektit të studimit të lëndës përkatëse në funksion të arritjes së objektivave të vendosur. Vihet re se ato përshtaten vit pas viti duke reflektuar ndryshimet legjislative apo pasurimin e literaturës. Në disa raste vihet re një mbivendosje e lehtë e lëndëve, si p.sh. E drejta Private Europiane trajton tema të përafërta me lëndën e Drejta Tregtare në BE, ose me lëndën e E Drejta e Procedurës Civile e BE-së. Ndërkohë që dy lëndët e fundit pasqyrojnë me saktësi objektin e tyre të studimit, E Drejta Private Europiane reflekton më tepër objektin e studimit të lëndës E Drejtë Europiane duke trajtuar liritë themelore dhe tregun e përbashkët, ndërkohë që lë jashtë programit zhvillime të rëndësishme në të drejtën e BE që prek institute thelbësore të së drejtës civile kombëtare të shteteve anëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, si p.sh. të drejtën kontraktore të fokusuar kryesisht në kontratat konsumatore për shkak të kompetencave të limituara që ka BE. Gjithashtu në të Drejtën Private Europiane nuk pasqyrohen kontribute të çmuara intelektuale si Projekt-Korniza e Përbashkët e Referencës (DCFR- Përpjekja për hartimin e një Kodi Civil Europian) apo Parimet e të Drejtës Europiane Kontraktore (Lando Principles), si dhe institute të tjera të së drejtës civile të cilat kanë



marrë një rregullim në nivel të BE, si p.sh. përfaqësimi (agjenti tregtar) apo përgjegjësia për shkaktimin e dëmit (produktet me defekt) etj. Përsa qe i është dhënë lëndës dhe përmbajtja e saj aktuale lejon hapësirën për ta strukturuar lëndën në tre pjesë kryesore duke trajtuar fillimisht aspekte të përgjithshme të kompetencës së BE dhe burimet primare, sikurse Traktatet (TBE; TFBE mbi lirinë e mallrave, kapitalit, sipërmarrjen, dhe konkurrencën) dhe më pas në pjesën e dytë fokusi vendoset në institute të së drejtës materiale (kontratat, detyrimet, shkaktimin e dëmit, i.e. Direktiva 93/13, 99/44, 85/374 etj.), ndërsa pjesa e tretë mund ti dedikohet instituteve të së drejtës europiane private ndërkombëtare (konflikt i ligjeve, i.e. Rregulloret Romë I, Romë II), duke lënë jashtë tematikave të trajtimit aspekte procedurale të cilat trajtohen me korrektesë në lëndën E Drejta e Procedurës Civile në BE.

Ndërsa lënda "E drejta tregtare e thelluar" pasqyron kryesisht objektin e studimit të lëndës e drejta e shoqërive tregtare. Meqenëse titullohet 'e thelluar', në të mund të ishin prezantuar edhe koncepte më të avancuara në këtë fushë, si p.sh. forma të tjera të bashkëpunimit tregtar, investimet kolektive, etj.

Syllabuset përfshijnë literaturën e detyruar dhe atë ndihmëse. Literatura e detyruar përgatitet në formën e leksioneve dhe materialeve nga personeli akademik i angazhuar në lëndë dhe supozohet e përditësuar, ndërsa literatura ndihmëse është e këshillueshme të përditësohet duke reflektuar literaturën e botuar në pesë vitet e fundit, me qëllim pasqyrimin e këndvështrimeve më bashkëkohore në shkencën e së drejtës.

Forma e vlerësimit të studentëve është unifikuar për të gjitha lëndët, duke e ndarë vlerësimin në përqindje: konkretisht 60% të lëndës e përbën nota përfundimtare; 30% punimi i eseve dhe 10% frekuentimi në leksione dhe seminare.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi i studimit Master i Shkencave në e Drejtë Civile dhe Tregtare është akredituar për herë të parë në vitin 2017 me Vendim BA Nr. 39, datë 19.05.2017 (kohëzgjatja 2 vite, me afat 31.07.2019).
<b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Programi i studimit Master i Shkencave në e Drejtë Civile dhe Tregtare është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);  Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Ngarkesa mësimore është e baraspeshuar në semestra.
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe	Sipas Strategjisë së Zhvillimit të FSHJMN të UMSH, Programi Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare i pajis studentët që kanë përfunduar studimet në Bachelor me njohuri më të thelluara në fushën e të drejtës civile, tregtare,



<p>trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>falimentimit etj, në teori dhe praktikë.</p> <p>Programi Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare është i bazuar në njohuri bazë të fituara gjatë ciklit të parë Bachelor, të cilat thellohen edhe më shumë në ciklin e dytë të studimeve me vështrim adekuat edhe në zhvillimet e të drejtës europiane në këto fusha.</p> <p><b>Kriteri 4 nuk aplikohet në këtë program studimi.</b></p> <p>Objektivi i programit është të përgatisë studentë në nivel specialistësh, ekspertë në fushën e studimeve juridike, të cilët janë mirëpritur dhe konsideruar në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Programi Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare u jep studenteve kompetenca, aftësi dhe njohuri të qëndrueshme për të kaluar në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p><b>Nuk aplikohet në këtë program studimi.</b></p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit përputhen tërësisht me ato të studimeve në nivelin e dytë. Programi ofron njohuri të thelluara teorike në studime juridike civile dhe tregtare, si dhe zbatimin praktik të tyre.</p> <p>Metodat e përdorura për vlerësimin e studentëve të MSc në E Drejtë Civile dhe Tregtare janë: angazhimi në seminar, detyrat e kursit, si dhe provimet përfundimtare.</p> <p>Procesverbalet e provimeve janë të qarta duke evidentuar pikët e fituara në seminar (10%), pikët e</p>

	<p>detyrave të kursit (30%) dhe pikët në provimin përfundimtar (60%). Komisioni i provimit përbëhet nga dy pedagogë të cilët firmosin proces-verbalin përfundimtar. Bazuar në rezultatet e vitit të parë, vitit të dytë të studentëve të Msc, rezulton se metodat e vlerësimit të përmendura më lart kanë qenë të efektshme duke bërë që studentët të jenë të përfshirë në mënyrë aktive, të interesuar dhe dinamik në përfitim të dijeve dhe aftësive praktike, të cilat përligjen në interesat e tyre për të kryer studime në këtë fushë.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Sipas RVB dhe referuar Programit të studimit në MSc E Drejtë Civile dhe Tregtare reflektohet se ky program është hartuar duke u mbështetur në eksperiencat e universiteteve europiane me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare është ndërtuar mbi bazën e frymës së programeve të studimeve europiane dhe më gjerë. Ky aspekt është i dukshëm në përmbajtjen e programit dhe të syllabuseve të lëndëve specifike si p.sh. E Drejtë e Krahasuar Civile, E Drejtë Tregtare e BE, E Drejtë e Procedurës Civile në BE, E Drejtë Tregtare Ndërkombëtare, E Drejtë e Falimentimit etj.</p> <p>Programi është ndërtuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara në mënyrë të tillë që studentët në përfundim të studimeve në MSC lehtësisht mund të aplikojnë në institucione rajonale dhe më gjerë për studime të mëtejshme ose të përafërta të krahasuara.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të</p>	<p>Programi i studimit i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare në mënyrën e ndërtimit përmban dy komponentë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësimin teoriko-praktik nëpërmjet praktikave në auditor, si dhe praktikave profesionale.</li> <li>• Kërkimin shkencor nëpërmjet punës së pavarur të finalizuar me përgatitjen e temës së diplomës.</li> </ul> <p>Studenti përmes këtij programi rrit njohuritë teorike dhe praktike duke iu afruar nevojave të</p>

<p>studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>tregut të punës dhe thellon aftësimin në drejtim të kërkimit shkencor. Në program përmbahen lëndë të cilat ndërthurin njohuritë teorike me ato të zbatuara si p.sh. E Drejta Kontraktore dhe Teknikat Kontraktore.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga departamenti janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Departamenti, nisur nga strategjia e zhvillimit të institucionit, ka hartuar strategjinë e tij si edhe planin e masave në kuadër të realizimit strategjisë së zhvillimit të institucionit.</p> <p>Për realizimin në nivel bashkëkohor dhe me cilësi programin e studimit Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare i gjithë personeli akademik angazhohet në kërkime shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca (referuar formatit të punës shkencore të Lektorëve, të paraqitur edhe në CV e tyre si dhe nga kontrolli i dosjeve të personelit realizuar nga GVJ).</p> <p>Nga kontrolli i dosjeve të personelit akademik realizuar nga GVJ në Institucion, rezultoi se angazhimi i personelit në punën kërkimore shkencore përgjithësisht përkon me fushat e mësimdhënies ku ata janë të angazhuar dhe me qëllimet e programit të studimit.</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>NA</p> <p>NA</p>
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <p>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;</p>	<p>Bazuar në dokumentin "Analizë e Nevojave të Tregut..." të UMSH dorëzuar si Aneks VIII, Departamenti i të Drejtës Civile, përmes analizës të tregut të punës e ka përshtatur programin e studimit MSC në E Drejtë Civile dhe Tregtare me nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>Institucioni ka paraqitur një dokumentacion mbi</p>

<p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritsëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>studimin e tregut, i cili pasqyron të gjitha programet e UMSH, përfshirë (në pikën 4, f. 3 të tij) një pasqyrim për nevojat e tregut për specialistë juristë. Vëzhgimi i tregut të punës përfshin mundësitë e punësimit, nevojat aktuale të tregut të punës për fushën e së drejtës civile dhe tregtare, si dhe kërkesat e studentëve për t'u specializuar në këto drejtime.</p> <p>Pavarësisht se studimi nuk është kryer posaçërisht për programin e Master në të Drejtë Civile dhe Tregtare dhe nuk pasqyron në mënyrë të detajuar kërkesat e Kriterit 2, nga ky studim rezultojnë nevoja dhe kërkesa për specialistë juristë në të drejtë tregtare dhe kontraktore.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare, i cili është hapur në bazë të Urdhrit Nr. 345 datë 17.09.2015 i Ministrit të Arsimit dhe të Sportit, është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ka synim parësor ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Fokusi në zhvillimet aktuale të së drejtës europiane në drejtim të së drejtës civile dhe tregtare dhe studimi i të drejtës civile të krahasuar përputhen me aspiratat kombëtare për integrim europian, pranimin e diversitetit dhe tolerancën kombëtare.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi i studimit MSC në E Drejtë Civile dhe Tregtare realizohet me 120 ECTS dhe një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>NA</p>

Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	
<b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshëm për studentët;	Sipas Rregullores së programit, Departamenti i të Drejtës Civile informon kandidatët për programin e studimit, stafin akademik, modalitetet e punimit të diplomës, etj. Në çdo program lënde, është parashikuar se ora e parë është njohja e studentëve me syllabusin, objektivat e lëndës dhe temat që do zhvillohen në lëndë.
<b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Sipas intervistave të realizuara me stafin akademik, ata komunikojnë me studentët si me formë të shkruar, ku materialet e printura lihen në biblioteke, ashtu edhe në formë elektronike me e-mail.
<b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Plani mësimor, është ndërtuar me qëllimin që diplomimi të realizohet në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar (2 vite akademike). Mënyra e diplomimit është e parashikuar në udhëzimin për punimin e diplomës dhe kalendarin e diplomës, të cilat u bëhen me dije studentëve dhe pedagogëve që në fillim të muajit dhjetor.
<b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	(Aneks: udhëzimi për punimin e diplomës, formatet) Bazuar në VKM. Nr. 41, datë 24.1.2018, Shtojca Nr. 1, Projekti kërkimor dhe teza e diplomës në programin Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare është parashikuar në 18 kredite europiane ETCS. Për kryerjen me sukses të punimit, në program janë parashikuar edhe seanca konsultative/metodologjike.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Organizimi i programit të studimit Master në E Drejtë Civile dhe Tregtare është në përputhje me standardet Europiane, ku lëndët ndahen në sistemin europian të krediteve ETCS. Plani mësimor ndahet sipas disiplinave të formimit të përgjithshëm, formimit karakterizues, të ngjashme duke realizuar një ndërthurje harmonike të semestrave. Kohëzgjatja e studimeve është 2 vite akademike e ndarë në 4 semestra, me nga 30 kredite (ECTS) secili.</li> <li>2. Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit synojnë arritjen e qëllimeve në mënyrë të përshtatshme me nivelin e studimeve.</li> </ol>	

3. Institucioni disponon dokumentacion për studimin e tregut të punës, pavarësisht se *jo specifik për programin e studimit nën shqyrtim*.
4. Syllabuset e një lënde duhen rishikuar me qëllim që të mos ketë mbivendosje me lëndët e tjera, konkretisht E Drejta Private Europiane. Ndërsa syllabusi i lëndës "E drejtë tregtare e thelluar" ose mund të titullohet si "E drejtë e thelluar e shoqërive tregtare", ose në të mund të reflektohen disa tema shtesë në mënyrë që përmbajtja të përshtatet sa më mirë me titullin e lëndës. Në tërësinë e tyre syllabuset vlerësohen si cilësore në përputhje me standardet.
5. Programi kujdeset për ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Rëndësi i kushtohet si studimit të së drejtës kombëtare, ashtu edhe asaj europiane dhe ndërkombëtare, duke pasqyruar kur është e nevojshme përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Europian sipas kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.
6. Studentët informohen mbi modalitetet e punimit të diplomës dhe për mbështetjen e tyre gjatë punimit të temës zhvillohen seanca konsultative/metodologjike individuale.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkruese

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njesisë etj.

Bazuar në RVB, Syllabuset e lëndëve të programit, si dhe intervistave me drejtuesit dhe personelin akademik gjatë vizitës në institucion rezulton se format e mësimdhënies janë kryesisht leksionet, seminarët, praktika profesionale dhe orët e konsultimit. Të gjitha lëndët e zhvilluara në program janë semestrare. Ngarkesa e orëve në auditor është ndarë ndërmjet leksioneve dhe seminarëve, ku pjesën më të madhe e zë zhvillimi i leksioneve, zakonisht në raportin 60% kreditet në leksione dhe 40% kreditet në seminare.

Kontrolli i njohurive të studentëve kryhet përgjatë të gjithë semestrit gjatë të cilit zhvillohet lënda. Sistemi i pikësimit për vlerësimin e përgjithshëm të studentëve konsiston në disa elemente kontrolli: 10% e pikëve vlerësohet nga pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare dhe leksione; 30% vlerësohen pikët nga detyra e kursit; dhe 60% e pikëve vlerësohen nga provimi përfundimtar në fund të semestrit.

Sipas syllabuseve të lëndëve parashikohet se metodat e mësimdhënies janë: leksione në auditor; leksione nga lektorë të ftuar, personalitete në fushë; diskutime, debate gjatë seminarëve; simulim situatash konkrete; brain-store dhe brain storme; përgatitje esesh dhe kërkim hulumtues dhe prezatim i kërkimit. Forma elektronike përdorej për shkëmbim informacioni ndërmjet studentëve në lidhje me detyrat e kursit ashtu edhe ndërmjet pedagogëve dhe studentëve, në lidhje me materialet e studimit. Nga vëzhgimi i grupit të RVJ në Institucion, përdorej edhe prezantimi ppt i leksioneve.

Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies realizohej në ndjekjen e leksioneve nga përgjegjësi i departamentit të së Drejtës Civile si dhe nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare. Nga biseda me drejtuesit gjatë vizitës në IAL u pohua se nga kontrollat e realizuara janë mbajtur shënime të sakta nga përgjegjësi i departamentit të cilat më pas janë referuar dhe Dekanit të Fakultetit.

Personeli akademik vetëvlerësohej gjithashtu. Një model praktike iu vendos në dispozicion grupit të punës për RVJ. Krahas këtij vlerësimi, jepeshin edhe mendime, sugjerime dhe vërejtje nga studentët nëpërmjet anketimeve për Lektorë të ndryshëm dhe lëndë të ndryshme. Studentët kishin mundësi të diskutonin dhe jepnin mendime mbi mundësitë e zhvillimit dhe përmirësimit të procesit mësimor.

Nga drejtuesit, lektorët dhe vetë studentët u pohua se studentët aktivizoheshin dhe merrnin pjesë gjatë aktiviteteve shkencore të organizuara nga institucioni, leksionet e hapura, diskutimet shkencore të mbajtura nga vetë lektorët ose të ftuarit.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Shih Tabelën Nr. 9 në aneks):

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Format e kontrollit të njohurive

Sipas RVB, programeve lëndore dhe proces-verbalit analitik të provimeve rezulton se studenti vlerësohet për aktivizimin gjatë orëve mësimore në masën 10%, gjatë kontrollove semestrare nëpërmjet detyrave të kursit ose testeve në masën 30% dhe në provimin përfundimtar në masën 60%.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.


Sipas RVB janë dhënë disa shifra, ku në nivel të aktivitetit të departamentit rezulton të jenë përfshirë 10 studentë, por këto shifra janë dhënë në nivel institucional dhe jo për sa i përket programit master në proces riakreditimi. Sipas intervistave të realizuara me drejtuesit dhe personelin akademik u pohua aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë.

Sipas shkresës së datës 12.11.2018 janë listuar një sërë aktiviteteve në format referimesh nga personeli akademik ku marrin pjesë edhe studentët.

Gjatë vizitës në Institucion u vu re se FSHJMN sapo kishte inauguruar krijimin e Klinikës së Ligjit e cila synonte një aktivizim më të madh të studentëve nën mbikëqyrjen e pedagogëve trajnues dhe instruktues.

Në nivel Fakulteti studentët merrnin pjesë edhe në konkursin 'Gjyq Simulues GJEDNJ- Shqipëri...' në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga KEDNJ organizuar nga Qendra Europiane dhe organizata Civil Rights Defender.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion  
-format proces-verbali vlerësimi të studentëve.



## 9. Studentët

### Pjesa përshkruese

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve janë të përcaktuara në Kreu III, nenet 12-15 të Rregullores së Programit të Studimit Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare.

Sipas RVB, intervistave të realizuara me stafin dhe studentët, pranimi i studentëve në programin Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare realizohet në përputhje të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore në fuqi si dhe në Statutin e UMSH dhe në Rregulloren e programit të studimit. Bazuar në këto akte ligjore si dhe verifikimin me profesionalizëm të të gjithë dokumentacionit shkresor të kërkuar, pranohen të gjithë ata studentë që kanë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ETCS.

Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publik në faqen zyrtare të UMSH, broshurën informuese si dhe gjatë fushatës mediatike. Studimet në ciklin e dytë MSC në E Drejtë Civile dhe Tregtare, i japin rëndësi përveç punës në auditor edhe:

- punës së pavarur të studentëve si detyrat e kursit, temat e diplomë;
- praktikës mësimore;

Kriteret për pranimin e studentëve në programin MSC në të Drejtë Civile dhe Tregtare janë të përcaktuara në nenin 12 të Rregullores së Programit, sipas të cilit kërkohet që studenti të ketë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkencë juridike dhe të ketë grumbulluar 180 ECTS. Gjithashtu pranohen edhe ata studentë që kanë përfunduar studimet universitare pa grumbulluar kredite, sipas rregullave ligjore të njëhsimit të diplomave. Ky rregull nënkupton ata studentë të cilët kanë përfunduar studimet në bazë të sistemit të vjetër të arsimit të lartë. Gjithashtu, në këtë program studimi pranohen edhe studentë të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në degë a profile të ngjashme me shkencat juridike, të cilët u nështrohen plotësisht të krediteve dhe ekuivalentimit të diplomës përpara se të fillojnë ndjekjen e studimeve në këtë program.

Përveç, sa më sipër studenti duhet të ketë njohje edhe të një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian, sipas niveleve dhe diplomave që përcaktohen në aktet e Ministrisë së Arsimit. Studentët që kanë ndjekur studimet e ciklit të parë në një nga pesë gjuhët, (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht) nuk ka nevojë të paraqesë një dëshmi të veçantë të njohjes së gjuhës së huaj.

Studenti që dëshiron të ndjekë studimet në këtë program studimi duhet të dorëzojë pranë Departamentit të së Drejtës Civile një kërkesë, fotokopje të notuar të ID, diplomën e ciklit të parë të shoqëruar me listën e notave si dhe dëshminë e gjuhës së huaj sipas përcaktimeve të specifikuara nga Ministria e Arsimit.

Sipas nenit 16 dhe 24 të Rregullores së Programit të Studimit, koha mesatare e zgjatjes së studimeve është dy vite akademike, gjatë të cilave studenti duhet të grumbullojë 120 kredite, pas të cilave ai diplomohet si "Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare".

Përsa i përket numrit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi, vihet re një tendencë e qëndrueshme në numrin e studentëve, me një rritje të vogël përsa i përket vitit akademik aktual. Në vitin akademik 2017-2018 kanë ndjekur studimet 75 studentë, ndërsa në vitin akademik 2018-2019 janë duke ndjekur studimet 79 (3 të transferuar) studentë në programin e studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare. Departamenti i të Drejtës Civile është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare.



Institucioni i Arsimit të Lartë UMSH mban kontakte me studentët e diplomuar (ALUMNI) dhe zotëron informacion në lidhje me punësimin e tyre duke përpunuar dhe statistikën përkatëse.

Kandidatët që kërkojnë të ndjekin këtë program studimi, sipas Nenit 13 të Rregullores së programit informohen mbi rregulloren, planin e studimeve, kriteret e pranimit, personelin akademik të përfshirë në mësimdhënie, modalitetet e punimit të diplomës, etj. Gjithashtu nëpërmjet faqes së internetit dhe sekretarisë studentëve u jepen informacione të ndryshme.

#### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

Procedurat e pranimit të studentëve

Sipas Rregullores së Programit të Studimit Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare pranimi i studentëve realizohet sipas kriterëve ligjore pasi studenti të ketë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në fushën e drejtësisë ose në fusha të përafërta dhe të ketë grumbulluar 180 ECTS. Në rast se studenti ka përfunduar programe të ngjashme studimi brenda ose jashtë vendit pranimi i tij kryhet vetëm pasi të jetë realizuar ekuivalentimi. Sipas RVB Regjistrimi i studentëve në Fakultetin e Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të UMSH bazohet në legjislacionin në fuqi, Statutin e UMSH, në Rregulloren e organizimit të universitetit, si dhe në udhëzimet e nxjerra nga Rektori i Universitetit për çdo vit akademik. Kandidati fiton statusin e studentit kur: a) regjistrohet në sekretarinë mësimore në përputhje me procedurën ligjore të regjistrimit; b) dorëzon dokumentacionin e kërkuar; c) paguan tarifën e regjistrimit; d) nënshkruan kontratën e studimit. Statusi i studentit përfundon me diplomimin ose me përjashtimin e tij nga UMSH për arsye objektive.

Sipas Nenit 13 të Rregullores së Programit të Studimit Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare bëhet nga një komision i ngritur nga Dekani. Komisioni vlerëson dokumentacionin dhe dosjen e kandidatit dhe bën renditjen e tyre. Listat e fituesve shpallen nga Dekani i Fakultetit.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Sipas tabelës së paraqitur në RVB nota mesatare e hyrjes së studentëve është 7.5 për vitin akademik 2017-2018 dhe 7.1 për vitin akademik 2018-2019. Nuk ka të dhëna statistikore për cilësinë në dalje sepse studentët nuk janë diplomuar ende.

Nga inspektimi i regjistrave dhe proces-verbaleve gjatë vizitës së GVJ në Institucion dukeshin që studentët të kishin relativisht cilësi të mirë për provimet që kishin kaluar.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela në aneks):

Në vitin e parë janë regjistruar gjithsej për herë të parë 75 studentë për vitin 2017-2018 dhe 76 studentë për vitin 2018-2019. Gjatë vitit 2018-2019 janë transferuar 3 studentë në vitin e dytë.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Ende nuk janë diplomuar studentë nga akreditimi i parë, pasi studimet zgjasin dy vite akademike dhe vit akademik i dytë përfundon në korrik -shtator 2019.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Sipas RVB, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor Nr. 80/2018, datë 22.07.2015, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe bazuar në Statutin e UMSH, neni 76, Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" njih kreditet e përfituara dhe transferon studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion dhe institucioneve të tjera. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimesh dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse të institucionit. Njohja

e plotë ose e pjesshme e krediteve të fituara nga studentët me qëllim vazhdimin e studimeve në UMSH kryhet nga një komision *ad hoc*.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Duke qene se për vitet që kryhet akreditimi 2017-2019 nuk ka ende të diplomuar, u mbledhën të dhënat për të diplomuarit e viteve të mëparshme. Sipas të dhënave të marra në Institucion gjatë vizitës së realizuar nga GVJ u mbledhën të dhënat si më poshtë:

Për vitin 2016-2017 janë diplomuar gjithsej 37 studentë, nga të cilët janë punësuar 21 në përputhje me diplomën dhe 14 jo në përputhje me diplomën.

Për vitin 2017-2018 janë diplomuar gjithsej 43 studentë, nga të cilët janë punësuar 27 në përputhje me diplomën dhe 13 jo në përputhje me diplomën.

Periudha e të dhënave (p.sh. 2016-2018)			
Programi i studimit MSc në EDCT	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
2016-2017	37	21 (57%)	14 (38%)
2017-2018	43	27 (63%)	13 (30%)

Numri total të diplomuarve

Nga momenti i akreditimit të parë nuk kemi të dhëna për studentët e diplomuar për arsyet e parashtruara më sipër. Por gjatë viteve 2016- 2017 dhe 2017-2018 janë diplomuar gjithsej 80 studentë.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 48 studentë të diplomuar në vitet 2017 dhe 2018.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve në jo në përputhje me diplomën është gjithsej 27 studentë të diplomuar në vitet 2017 dhe 2018.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion  
- Të dhëna për studentët e diplomuar, të transferuar etj.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Sipas Rregullores së Programit dhe RVB, Studentët që ndjekin programin Master i Shkencave në E drejtë Civile dhe Tregtare zotërojnë së paku diplomën universitare bachelor dhe kanë grumbulluar 180 ECTS.
<b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për	Pranimi i studentëve në programin MSC në të

<p>arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p>	<p>Drejtë Civile dhe Tregtare bëhet në përputhje me ligjin e ri Për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Pranimi bëhet pasi është bërë kontrolli i dosjes me dokumentacionin e kërkuar nga një komision i ngritur nga Dekani i Fakultetit.</p> <p>Pranimi në ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me specifikat e programit, mundësitë akademike, nevojat e tregut si dhe mundësitë infrastrukturore të institucionit. Bazuar në rregulloret e programeve të studimit institucioni shpall kriteret specifike të pranimit Studentët e kanë kriter hyrës që në regjistrim, depozitimin e certifikatës së njohjes së një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European, sipas akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Sipas RVB, përzgjedhja e kandidatëve në programin e studimit MSC në E Drejtë Civile dhe Tregtare bëhet konform akteve ligjore dhe nënligjore, duke pasur parasysh edhe politikat institucionale.</p> <p>Institucioni, duke pasur në vëmendje të posaçme politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, duke u mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe Akteve Institucionale të UMSH, harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>
<p><b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit dhe RVB studentëve në UMSH u jepet shërbimi nga Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Institucioni zotëron dokumentacionin për studimin e tregut ku tregohen edhe nevojat e tregut për punësimin e juristëve të specializuar në të Drejtë Civile dhe Tregtare (f. 3, pika 4 e dokumentit "Analizë e Nevojave të Tregut...". Sipas plan veprimt të Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës për vitin 2018-2019 është planifikuar krijimi i një ure komunikimi me studentët si dhe rishikimi i rregullores përkatëse për një funksionim sa më të përshatshëm.</p> <p>Nga takimi i zhvilluar me studentët rezultoi se ata ishin të njohur si për mundësitë e</p>

	<p>punësimit, ashtu edhe për akreditimin e programeve të studimit.</p> <p>Shumë prej studentëve pjesëmarrës në takim ishin të punësuar dhe disa prej tyre të punësuar në fushën profesionale, për të cilën po kualifikoheshin.</p> <p>Studentëve u jepej informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion.</p> <p>Në UMSH, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës mbështet studentët gjatë të gjithë kohëzgjatjes së studimeve të tyre si dhe i orienton ata në lidhje me mundësitë për kryerjen e studimeve të mëtejshme të doktoraturës. Orienton në pjesëmarrjen e studentëve në projekte të ndryshme studimore, stimulon studentët të marrin pjesë në programe dhe konkurse kombëtare, ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë intervistave me personelin përgjegjës në ZKSK rezultoi se edhe pedagogët e departamentit përgjegjës për programin ishin të angazhuar aktivisht në shërbim të këshillimit të studentëve.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar në çdo program studimi. Institucioni disponon statistika vjetore për çdo student të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara. Këto të dhëna gjenden në çdo kohë në sekretarinë mësimore dhe në zyrën e statistikave.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p> <p>Nga takimi me punonjës të sekretarisë mësimore u verifikua nga GVJ dokumentacioni që disponohej për ecurinë e studentëve.</p> <p>Përgjegjësi i njësisë bazë në bashkëpunim me sekretarinë mësimore ka informacion të</p>

	vazhdueshëm për studentët që nga pranimi dhe deri në diplomimin e tyre.
<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni mban në vazhdimësi statistika për ecurinë e karrierës së studentëve të tij. Këtu e realizon nëpërmjet ruajtjes së kontakteve me ta edhe pas mbarimit të studimeve. Sipas RVB dhe gjatë vizitës në IAL u konstatua se Institucioni punësonte vetë studentët më të mirë. Gjithashtu u vu në dispozicion edhe formati i Librit Alumni.</p> <p>Sipas RVB dhe konstatimeve gjatë vizitës në Institucion, krahas mbajtjes së të dhënave në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar, IAL mban dhe azhurnon në mënyrë sistematike të dhënat në lidhje me numrin e studentëve që vijojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve, madje duke nxitur dhe inkurajuar ish studentët e punësuar si personel akademik të vijojnë me studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve.</p>
<b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Sipas RVB, që në momentin e regjistrimit dhe në vijim studentët informohen mbi programin e studimit në Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare, titullarët e lëndëve, organizimin e tij në 4 semestra dhe gjithçka tjetër ndodh me procesin e akreditimit të programit. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët në Institucion.</p> <p>Studentët informoheshin mbi rezultatet e vlerësimit në sistemin elektronik të regjistrimit të tyre., ku kishin akses përmes llogarisë individuale.</p> <p>Në procesverbalin e notës përfundimtare pasqyroheshin të gjithë komponentët e vlerësimit (pikët e seminarit, detyrës së kursit dhe provimit përfundimtar). Nëse studentët kërkonin sqarime kjo realizohej nëpërmjet seancave sqaruese me pedagogun e lëndës. Vetëm pas shpjegimit të kërkuar që u jepej studentëve, vlerësimi fiksohej përfundimisht në procesverbal dhe në sistemin elektronik përkatës.</p>

**Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.**


**Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

IAL nëpërmjet strukturave të ngritura, në veçanti Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, ofron asistencë për studentët lidhur me procesin mësimor, formimin akademik, zhvillimin e karrierës dhe çështje të tjera të jetës studentore. Ndër të tjera funksionon sistemi i tutoriatit, i cili realizohet me angazhimin e personelit akademik, administrativ dhe në bashkëpunim me organet studentore. Nga IAL është miratuar Udhëzues 'Për autoritetin, përgjegjësinë dhe veprimet e tutoriatit në UMSH'. ZKSK ka një plan veprimi të detajuar lidhur me koordinimin dhe kryerjen e aktiviteteve të këshillimit, praktikave mësimore aktivitetit të këshillit studentor, etj. UMSH nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me institucionet publike dhe private në vend u mundëson studentëve kryerjen e praktikës profesionale sipas specifikimit të degës përkatëse, si pjesë përbërëse e planit mësimor. Sipas dokumentacionit të depozituar nga IAL dhe gjatë intervistave në Institucion, rezultoi se procedura e praktikës është standardizuar qartë nga IAL. Departamenti së bashku me Dekanatin e FSHJMN janë përgjegjës për realizimin e praktikës profesionale të studentit. Praktikën profesionale zhvillohen nën mbikëqyrjen e pedagogëve përkatës në institucione të ndryshme në bashkëpunim me persona përgjegjës në institucionin ku zhvillohet praktika. Studenti pas përfundimit të praktikës përgatit një raport për punën e kryer, sipas programit të praktikës dhe merr vlerësimin për praktikën nga nota më e dobët 4 deri në 10.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. GVJ konkludon se studentët që kanë aplikuar dhe janë pranuar në këtë program studimi kanë përfunduar studimet e ciklit të parë Bachelor, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH".
2. IAL informon studentët lidhur me statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.
3. IAL mban të dhëna lidhur me numrin e studentëve që ndjekin programin master.
4. IAL disponon të dhëna lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar, duke mbajtur Librin Alumni.



5. IAL informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar në lidhje me programin master.
6. IAL ndjek dhe këshillon vazhdimisht studentët në problematikat që ata hasin.
7. IAL ka standardizuar qartësisht procedurat e praktikës së studentëve duke lehtësuar orientimin për ta dhe ndihmën ndaj tyre.

### **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

#### **10. Kërkimi shkencor**

##### **Pjesa përshkruese**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Politikat e kërkimit shkencor janë përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit të FSHJMN për Programin MSHC në të Drejtë Civile dhe Tregtare. Strategjia synon në rritjen e kërkimit shkencor, pjesëmarrjen në aktivitete shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit të personelit akademik, aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimi në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, rritjen e numrit të botimeve të artikujve shkencore, monografive, teksteve mësimore në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe aftësimin më të lartë të personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie në këtë program. Institucioni ka organizuar disa konferenca shkencore përgjatë dy viteve të fundit, informacioni mbi të cilat u dha nga drejtuesit dhe personeli akademik i FSHJMN, informacioni mbi të cilat gjendet edhe në *website* të IAL umsh.edu.al.

IAL ka krijuar Qendrën e Kërkimit Shkencor e cila është strukturë përgjegjëse dhe ndihmëse në funksion të krijimit të bashkëpunimeve shkencore ndërkombëtare. Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me personat përgjegjës për Qendrën, rezultoi se janë ristrukturuar fushat e studimit me qëllim hapjen e shkollës doktoare, janë përpunuar indikatorët e vlerësimit të punës shkencore, janë krijuar bashkëpunime me institucione arsimore ndërkombëtare me qëllim unifikimin e programit të lëndëve për qëllime të njohjes dhe transferimit të krediteve (ECTS). Janë organizuar disa konferenca shkencore, ndërsa përvoja e përkjet projekteve, FSHJMN ende nuk është përfshirë në ndonjë projekt këto vitet e fundit, ndoshta edhe për shkak të ristrukturimit të brendshëm që ka pësuar IAL së fundi.

Gjithashtu në Institucion funksiononte edhe një njësi brenda NSBCZHK e cila angazhohej me aplikimin në projekte. IAL ishte pjesë e disa projekteve financuar nga fonde europiane, por konkretisht Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare nuk ishte ende i përfshirë.

Nga Tabela dhe materialet e vëna në dispozicion nga IAL rezultoi se ka një numër botimesh dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore nga personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin MSHC në të Drejtë Civile dhe Tregtare, të cilat demonstrojnë edhe lidhjen e kërkimit shkencor me fushat e tyre përkatëse të mësimdhënies.

Institucioni inkurajon dhe mbështet personelin akademik për kryerjen e aktiviteteve kërkimore jashtë vendit duke i mbështetur financiarisht, në formën e mos ndërprerjes së pagës. Gjithashtu, IAL i inkurajon ata të krijojnë profile publike dhe të shpërndajnë rezultatin e kërkimit edhe në platforma profesionale dhe shkencore si LinkedIn dhe ResearchGate (shih kontratën individuale të punës).

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabelat ne aneks)

Sipas Aneksit VI Përmbledhje e punës shkencore e FSHJMN dhe bazuar në CV e personelit akademik të angazhuar në Programin MSHC E Drejtë Civile dhe Tregtare rezultojn sa më poshtë:

Pedagogët e Departamentit të së Drejtës Civile (Njësia bazë përgjegjëse për organizimin e Programit MSC në të Drejtë Civile dhe Tregtare), ka realizuar për vitin 2017-2018, 8 artikuj shkencorë të botuar brenda vendit dhe 2 jashtë vendit; 1 monografi, 10 referime në konferenca shkencore brenda vendit dhe 5 pjesëmarrje në programe lokale/kombëtare e ndërkombëtare.

Për vitin akademik 2018-2019, janë realizuar 1 artikull shkencor i botuar brenda vendit dhe 2 jashtë vendit; 1 monografi; 3 referime në konferenca shkencore brenda vendit dhe 7 jashtë vendit, nga të cilat 5 në gjuhë të huaj.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion  
- Format/Përmbledhje Raportimi i punës shkencore

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Sipas RVB dhe konstatimeve në Institucion, personeli akademik që mbulon programin mësimor Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare është i angazhuar në publikime të artikujve dhe materialeve shkencore. Këto publikime janë të evidentuara në statistikën të cilat përpunohen periodikisht dhe nga të dhënat e përgjithshme që disponon departamenti dhe institucioni si dhe nga raportimet individuale të secilit pjesëtar të personelit akademik. Sipas RVB dhe intervistave të realizuara me personelin akademik në IAL, personeli akademik ka realizuar botime kryesisht lidhur me ndryshimet më të fundit ligjore. Nga vëzhgimi i disa botimeve vihet re se personeli akademik është angazhuar në analizimin e problemeve me rëndësi juridike në fushën e të drejtës tregtare.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certifikatë për njohje të avancuar të saj;	IAL në kuadër të bashkëpunimit me Universitetet e huaja ka angazhuar lektorë të huaj, konkretisht në lëndën e Drejtë Private Europiane, F.D. Sipas dosjes personale të Z. F.D, me gjuhë amtare italishten, rezultojn se ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në	



<p>mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>franceze. Sipas dosjes personale, rezulton që personeli akademik ka përvojë në mësimdhënie në gjuhën italiane dhe angleze. Nga dokumentacioni i konsultuar, Lektor i ishte përfshirë edhe në lëndë të Departamentit të së Drejtës Publike dhe eksperiencia e tij konsiston më së shumti në fushën e të drejtës penale.</p>
<p><b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>IAL informon periodikisht stafin pedagogjik mbi programe të reja studimi brenda dhe jashtë vendit, për t'u mundësuar atyre kualifikime të mëtejshme. IAL inkurajon personelin akademik për kualifikime të mëtejshme duke i mbështetur financiarisht, në kuptim të pagimeve të shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit, pagesën e tarifave për pjesëmarrje në konferenca. Aktualisht një lektor vazhonte kërkimet post-doktorale në Austri, ku kishte fituar një çmim. (Shih të dhënat tabelore f. 63 RVB).</p>
<p><b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Të dhënat për studimet shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare mbaheshin në dosjen e personelit akademik pranë zyrës së burimeve njerëzore, sipas një formulari të përcaktuar për aktivitetin shkencor, pjesëmarrjen në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, botime, etj. Dekani dhe Përgjegjësit e Departamenteve konfirmuan se në departamente gjenden dosjet përkatëse për secilin vit akademik mbi publikimet shkencore të stafit. Një kopje e botimeve të publikimeve shkencore gjendej në departament, pranë bibliotekës së institucionit si dhe në format elektronik pranë Qendrës së Kërkimit Shkencor të UMSH-së.  Ndërsa të dhëna të plota për projektet kërkimore të IAL-së gjendeshin pranë zyrës së projekteve. Personeli akademik i programit të studimit MSC në të Drejtë Civile dhe Tregtare ende nuk është përfshirë në projektet zyrtarisht të aprovuara, por</p>

nga Drejtuesja e Zyrës së Projekteve u konfirmua, se pritet një angazhim më lartë i tyre në të ardhmen e afërt.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Një pjesë e personelit akademik ka publikime në fushën përkatëse kërkimore dhe të mësimdhënies, të cilat janë me vlerë dhe për programet e studimit. Personeli akademik inkurajohet të botojë në revista cilësore kombëtare e ndërkombëtare në fusha që lidhen me programin e studimit. Në këtë mënyrë kërkimi shkencor i shërben mësimdhënies. IAL duhet të marrë masa të mëtejshme për përmirësimin sasior dhe cilësor të rezultatit të kërkimit shkencor, duke angazhuar personelin akademik në projekte kërkimore-shkencore.
2. Programi ofrohet në gjuhën shqipe nga personel akademik i kualifikuar. Një lëndë zhvillohet në gjuhën angleze.
3. IAL u ofron mbështetje financiare anëtarëve të personelit akademik për vizita studimore dhe kualifikim jashtë vendit.
4. IAL disponon një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore shkencore, pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe botime të personelit akademik.

**11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

**Pjesa përshkruese**

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Sipas RVB (f. 68 et seq.) janë renditur një numër i lartë institucionesh publike, organizata profesionale e biznesi vendase dhe të huaja me të cilat UMSH ka bashkëpunim. Ndër të tjera përmenden marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel kombëtar me Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Jashtme, Kuvendin e Shqipërisë, Dhomën kombëtare të Ndërmjetësve, Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë dhe në nivel ndërkombëtar me London Academy of Diplomacy kanë qenë frytdhënëse për Fakultetin Shkencave Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare si për kryerjen e praktikave të studentëve ashtu edhe për organizimin e Konferencave të përbashkëta ku kanë marrë pjesë të gjithë pjesëtarët e personelit akademik të angazhuar në FSHJMN dhe ato të angazhuar në programin e studimit Masteri i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare. Aktivitete të organizuara për studentë përmenden veçanërisht pjesëmarrja në Gjyqin Imitues të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, aktiviteti i përbashkët me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me rastin e Ditës Europiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Shkolla Dimërore "Informim dhe privatësi" etj.

E njëjta situatë u konfirmua edhe gjatë vizitës në IAL nga Drejtuesit dhe anëtarët e GVB.

Nga formatet e praktikave të vëna në dispozicion nga IAL rezulton se studentët kryejnë praktika mësimore pranë subjekteve të përmendura në RVB.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Plotëso Tabelat ne aneks)  
Sipas të dhënave të përmbajtura dhe në Tabelën Nr. 14 në aneks, IAL ka vënë në dispozicion disa tregues prej të cilëve rezulton se: 3 anëtarë të personelit akademik nga Departamenti i të Drejtës Civile janë përfshirë në projekte kombëtare e ndërkombëtare si partnerë

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë .

Në përputhje me Tabelën Nr. 15 në aneks, UMSH ka bashkëpunim me një numër të lartë institucionesh e subjektsh të tjera publike dhe private, brenda e jashtë vendit. IAL, përveç të dhënave tabelore (RVB, f. 68-73), ndër të tjera ka paraqitur edhe një marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar se fundi me fondacionin bullgar Law and Internet Foundation, i cili është një qendër kërkimi për të drejtën dhe teknologjinë e informacionit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion  
- Marrëveshje bashkëpunimi

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Bazuar në formatin e shpërndarjes së praktikave dhe vlerësimin të tyre vënë në dispozicion nga IAL, për realizimin e një procesi të plotë mësimor dhe për të konkretizuar dijet, Institucioni mundëson që studentët të kryejnë praktika mësimore me Institucione dhe Organizata me të cilët ka marrëdhënie bashkëpunimi. Gjatë semestrit të dytë, të vitit të dytë të studimeve, UMSH u mundëson studentëve kryerjen e praktikave profesionale duke u ofruar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e saj.
<b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Sipas RVB dhe intervistave të realizuara gjatë vizitës në IAL u vu re se UMSH e ndërton aktivitetin e tij mbi bazën e bashkëpunimit të brendshëm midis personelit akademik, atij administrativ dhe të niveleve më të larta drejtuese. Fakulteti Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe në veçanti Departamenti i të Drejtës Civile ka në
<b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së	

<p>përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>përbërje të tij personel akademik të kualifikuar. Shumica mbanin gradën shkencore "Doktor". Personeli akademik kishte një sfond divers të edukimit, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Eksperienca e personelit akademik në kryerjen e cikleve të para, të dyta apo të treta në vende të huaja perëndimore kishte ndikuar në hartimin e një programi bashkëkohor studimi për Masterin e Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare.</p> <p>Gjatë takimit me drejtuesit e Fakultetit dhe Përgjegjësit e Departamenteve u evidentua se aktiviteti i departamenteve diskutohet dhe paraqitet në mënyrë të vazhdueshme në mbledhjet e Departamentit si dhe ato të Fakultetit të organizuara nga Dekanati. Nëpërmjet ndarjes së drejtë të punës nga ana e drejtuesit të departamentit si dhe të drejtuesve të fakultetit çdo anëtar i personelit akademik merr përsipër dhe realizon detyrat dhe përgjegjësitë e tij respektive. Dekani vuri në dispozicion të grupit të vlerësimit, edhe dokumente të cilat tregonin ndarjen e lëndëve dhe orëve mësimore mes pedagogëve për vitin akademik aktual. Sipas tij, realizimi i detyrave apo dhe mangësitë që ndonjëherë ndeshen gjatë punës diskutohen në mbledhjet e organizuara në mënyrë periodike në departament dhe në fakultet. Ndarja e qartë e detyrave eviton konfliktet dhe rrit përgjegjësinë e secilit. E gjitha kjo ka ndikuar në rritjen e një bashkëpunimi brenda institucionit.</p>
--	--

**Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.**

**Kriteri 1** Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

**Kriteri 2** Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të

Sipas RVB, UMSH, në funksion të programeve të studimit në fushën e drejtësisë ka zhvilluar bashkëpunimin me institucione homologe, në mënyrë që të përfitojnë reciprokisht për të realizuar objektivat e programeve të studimit. Sipas Formatit të shpërndarjes të studentëve praktikantë në Institucione, konstatohet se IAL ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe profesionistë në fushën e drejtësisë, si p.sh. me zyra noterie apo përmbarimi.

-UMSH, në sajë të marrëdhënieve të bashkëpunimit, të përmendura sipas Tabelës Nr. 15, ka garantuar mundësitë për kryerje të praktikës mësimore nga ana e studentëve. Sipas drejtuesve të Fakultetit dhe punonjësve të Zyrës së këshillimit të studentëve dhe


<p>përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>karrierës, marrëdhëniet e bashkëpunimit të vendosura me aktorët kryesorë të biznesit vendas apo të huaj mundësojnë edhe punësim për studentët e UMSH. IAL nuk vuri në dispozicion ndonjë dokumentacion që të provonte organizimin e trajnimeve të mëtejshme profesionale në bashkërendim me punëdhënësit potencialë të studentëve të diplomuar. Sipas RVB, UMSH analizon përfitimet e secilës prej marrëveshjeve të nënshkuara, në funksion të programeve të studimit në drejtësi dhe veçanërisht të programit të studimit Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare. Raporti analitik i tyre synon të paraqesë rezultatet konkrete të zbatimit të marrëveshjeve dhe dobitë që mund të sjellin në këtë program studimi. Por, GVJ-së nuk iu vu në dispozicion ndonjë raport konkret.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. IAL ka paraqitur një listë të gjatë institucioneve publike dhe private me të cilat ka marrëveshje për kryerjen e praktikave të studentëve. Standardizimi i formatit dhe vlerësimit të praktikave e dëshmon këtë.</li> <li>2. IAL garanton marrëdhënie të mira bashkëpunimi mes personelit akademik si në funksion të përmirësimit të kurrikulave të programit ashtu edhe të rritjes profesionale të personeli akademik.</li> <li>3. IAL dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit. Marrëveshja e datës 7.5.2019 me Law and Internet Foundation, me qendër në Sofje, Bullgari është sjellë si një nga provat.</li> </ol>	

### **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

#### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

(Grupi shprehet për plotësimin/mosplotësimin/plotësimin e pjesshëm të rekomandimeve)

GVJ ka kontrolluar dhe vlerësuar punën e bërë nga IAL-ja në lidhje me akreditimin e fundit. Institucioni ka reaguar pozitivisht dhe ka shfaqur vullnet për plotësimin e detyrave të lëna, duke bërë parashikime të qarta në aktet e brendshme të funksionimit të tij, me qëllim ndarjen e barabartë të krediteve prej 60 të tilla në çdo vit studimi; ka realizuar ndryshimet përkatëse në aktet e brendshme të UMSH, ku parashikohen funksioni dhe detyrat konkrete të Koordinatorit të Programit të Masterit, duke u qartësuar roli i Koordinatorit dhe në ndryshimet strukturore brenda fakultetit; institucioni ka bërë ndryshimet e nevojshme në aktet e brendshme të funksionimit të tij, ku është parashikuar pjesëmarrja e Përgjegjësit të Departamentit në procesin e rekrutimit të personelit akademik, në mënyrë të detyrueshme; janë bërë ndryshime në aktet e brendshme të tij e për rrjedhojë, në kuadër të programit, praktika është realizuar në institucione të tilla si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritimit, etj.



Në këtë kuptim, *GVJ vlerëson se rekomandimet janë plotësuar nga ana e IAL.*

Aspekte të tjerë të përmirësuar lidhen me rritjen e cilësisë dhe e numrit të pedagogëve, të cilët përbëjnë stafin akademik. Kjo ka sjellë si pasojë rregullimin e kriterëve të nevojshëm për të qenë në standartet ligjorë. Nga ana tjetër, struktura e përshtatshme dhe mjetet ndihmëse mbeten të një cilësie të lartë nisur nga këto elementë, studentët janë shprehur të kënaqur nga kushtet e ofruara nga UMSH sa i përket formimit të tyre.

## **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

### **a. Pika të forta:**

- 1) UMSH ka vizion të qartë e Strategji zhvillimi në përputhje me kërkesat e tregut për të cilat ofrohet programi “e Drejtë Civile dhe Tregtare”. Drejtimit e përcaktuara në aktet rregullative të institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të programit janë të orientuara saktë e me perspektivë të qartë, duke i shërbyer efektivisht punës akademike.
- 2) Në programin në analizë, personeli akademik përbën një vlerë të shtuar sepse paraqitet me eksperiencë të thelluar në fushën civile dhe tregtare, ashtu si në fushën e drejtësisë në përgjithësi, duke siguruar një cilësi të lartë të mësimdhënies.
- 3) Staf i drejtues i Fakultetit paraqet eksperiencë të thelluar, si në fushën juridike, si në drejtim, duke orientuar punën organizative dhe akademike me profesionalizëm të lartë.

### **b. Pika të dobëta:**

- 1) Institucioni nuk ka përdorur ekspertizë jashtë Institucionit për vlerësimin e programeve të studimit dhe cilësinë akademike, duke kufizuar një burim të mundshëm për rritjen e mëtejshme Institucionale.
- 2) Mungesa e incentivave të dhëna nga IAL për shkëmbimin e studentëve me IAL të tjera jashtë vendit.
- 3) Mungesa e nxitjeve të mjaftueshme për personelin akademik në të drejtë civile dhe tregtare të përfshihet më aktivisht në realizimin e projekteve shkencore të IAL-së.

### **c. Mundësitë:**

- 1) Rritja dhe përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, duke krijuar mundësi thellimi në aspektet praktike të së drejtës dhe duke krijuar bazat e një bashkëpunimi më të zgjatur në kohë, edhe si alumni

- 2) Gjithashtu shfrytëzimi i mundësive për avancimin e anëtarëve efektivë të personelit akademik për t'u rritur më tej në drejtim të kualifikimit shkencor, por gjithashtu edhe në drejtim të kualifikimeve të mëtejshme në shkëmbime akademike e profesionale me Universitete të huaja të spikatura në fushën e drejtësisë.
- 3) Krijimi i hapësirave nga ana e IAL që përmes bashkëpunimeve të vendosura me institucione të huaja dhe mundësive të personelit akademik me edukim jashtë vendit të përdorin network-un e krijuar, të nxisë personelin akademik të organizojë dhe të marrë pjesë në më shumë evente shkencore të përbashkëta në fushën e të *drejtës civile dhe tregtare*.

**d. Pengesat:**

- 1) Jemi të mendimit se institucioni është plotësisht në gjendje të përmbushë ato që konsiderohen pika të dobëta nga ana jonë. Nga institucioni vetë konsiderohen pengesa ndryshimet e shpeshta në legjislacionin që vepron në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
- 2) Ngadalësimi i procesit të dhënies së gradave shkencore dhe titujve akademik në vend, mund të rrezikojë përmbushjen e nevojave të IAL për personel akademik të specializuar.

**e. Rekomandime**

- 1) Institucioni mund të kontraktojë ekspertë të jashtëm si në fushën akademike, si në fushën e organizimit të departamentit, po ashtu në sektorin e sigurimit të cilësisë, të cilët mund të japin një kontribut efektiv dhe të pavarur në rritjen e Institucionit.
- 2) Institucioni mund të nxisë studentët nëpërmjet stimujve të ndryshëm apo dhe publicitetit pozitiv që të aplikojnë për programe shkëmbimi me IAL të huaja. Rritja e shkëmbimeve mes studentëve, por edhe personelit akademik rrit natyrshëm edhe cilësinë e programit.
- 3) Forcimi i bashkëpunimeve me IAL të huaja dhe nxitja e personelit akademik aktual të specializohet dhe promovohet në institucione jashtë vendit.

**SUMMARY ANALYSIS ON THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM**

**I. SUMMARY ANALYSIS ON FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION**

The Evaluation Team expresses the fulfillment / partial fulfillment of the recommendations)

The External Evaluation Team has checked and evaluated the work done by the HEI regarding the last accreditation. The institution has reacted positively and has expressed willingness to fulfill its assigned duties by making clear predictions in the internal acts of its functioning, with the aim of equating the credits of 60 in each year of study; has implemented the relevant changes in UMSH's internal acts, which prescribe the function and tasks of the Master Program Coordinator, clarifying the role of the Coordinator and structural

changes within the faculty; the institution has made the necessary changes in the internal acts of its functioning, where it is envisaged the participation of the Head of Department in the process of recruitment of academic staff, in an obligatory manner; changes have been made to its internal acts and as a result, within the program, the internship (practice) has been implemented in institutions such as the Assembly, the Ministry of Justice, the Ministry of Integration etc.

In this sense, the EET estimates that the recommendations have been completed by the HEI.

Other improved aspects relate to increasing the quality and the number of academic personnel in line with legal standards. On the other hand, the appropriate structure and auxiliary tools remain of a high quality. Starting from these elements, students expressed their satisfaction with the conditions offered by UMSH regarding their education.

## **SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION (ASSESSMENT) REPORT ACCORDING TO SWAT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESS, OPPORTUNITIES, THREATS).**

### **a. Strengths:**


- 1) UMSH has a clear vision on development strategy in accordance with market requirements for which the "Civil and Commercial Law" program is offered. The directions set out in the institution's regulatory acts and the program's development strategy are accurate and clearly-oriented, with effective perspective serving academic work effectively.
- 2) In the program under analysis, academic staff is an added value because it is presented with profound experience in the civil and commercial field, just as in the field of justice in general, ensuring a high quality of teaching.
- 3) The faculty's staff presents profound experience, both in the field of law and in the direction, by orienting organizational and academic work with high professionalism.

### **b. Weakness:**

- 1) The institution has not used external expertise for evaluating study programs and academic quality, limiting a potential source for further institutional growth.
- 2) Lack of incentives given by HEI for exchange of students with other HEIs abroad.
- 3) Lack of sufficient incentives for academic staff in civil and commercial law to be more actively involved in the realization of scientific projects of HEIs.

### **c. Opportunities:**

- 1) Increasing number of students involved in research, creating opportunities for deepening the practical aspects of the law and creating the basis for a more prolonged cooperation in time, even as alumni.





- 2) Exploiting opportunities to advance effective members of academic staff to further increase both in terms of scientific qualification, and in terms of further continuous qualifications in academic and professional exchanges with foreign Universities emerging in the field of justice.
- 3) Creation of opportunities by the HEI through the cooperation established with foreign institutions, and by academic staff with education abroad to use the established network; to encourage academic staff to organize and participate in more cooperative and common scientific events in the field of civil and commercial law.

**d. Threats:**

- 1) We are of the opinion that the institution is fully able to fulfill what are considered weak points by us. The institution considered a barrier, the frequent changes in the legislation that operates in the field of higher education and research.
- 2) The slowdown in the process of awarding academic degrees and academic titles in the country may jeopardize the fulfillment of the needs of HEIs for specialized academic staff.

**e. Recommendations:**

- 1) The institution can outsource external experts in the academic field, both in the area of departmental organization, and in the quality assurance sector, which can make an effective and independent contribution to the institution's growth.
- 2) The institution may encourage students through various incentives or positive publicity to apply for exchange programs to foreign HEIs. Increased exchanges among students, but also academic staff naturally increases the quality of the program.
- 3) Strengthening of cooperation with foreign HEIs and encouragement of current academic staff to be specialized and promoted in foreign institutions abroad.

